



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

R A P O R T I M

**I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË
REPUBLIKËS**

NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

**“MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT NË SHQIPËRI
PER VITIN 2008”**

Shkurt, 2009

H Y R J E	2
VOLUMI I PUNËS SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2008	4
KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT	15
TË DHËNA PËR KRIMINALITETIN, DINAMIKËN DHE SHPËRNDARJEN E TIJ	18
I. VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT,	18
KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE (NENET 76-84):	18
II. NE LIDHJE ME VEPRËN PENALE TË VRASJES NGA PAKUJDESIA (NENI 85)	26
III. VEPRAT PENALE TË KRYERA ME DASHJE KUNDËR SHËNDETIT (NENET 86-90).	28
IV. Për veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës,	35
(nenet 93-99)	35
V. PËR KRIMET SEKSUALE	40
PËR VEPRAT PENALE TË TRAFIQEVE TË PALIGJSHME	45
VII. PËR VEPRAT PENALE PRODHIM TE NARKOTIKEVE, KULTIVIMIT DHE SHITJES SE TYRE	58
VIII. VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME SHFRYTËZIMIN DHE USHTRIMIN E PROSTITUCIONIT	64
IX. PËR VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT DHE QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË E KUNDRALIGJSHME TË PUNONJËSIT SHTETËROR OSE NË SHËRBIMIN PUBLIK,	68
X. Për veprat penale që lidhen me pastrimin e parave	84
PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIMIN E ORGANIZUAR	86
SEKSIONI “VJEDHJA E PASURISË”	87
SEKSIONI “MASHTRIMET” (Nenet 143- 149)	96
SEKSIONI “SHKATËRRIMI I PRONËS” (nenet 150-161)	101
SEKSIONI “KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE” (nenet 171-179/a)	110
SEKSIONI “ZHVILLIMI PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT” (nenet 197-198)	130
SEKSIONI “VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË” (nenet 300-324)	147
TE DHENAT PER TE PANDEHURIT PER VITIN 2008	150
TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KERKUARA NGA PROKURORËT	157
TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2008.	160
TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITITN 2008	162
PRIORITETET E ORGANIT TË PROKURORISË GJATË VITIT 2008 DHE PRIORITET PËR VITIN 2009	163

HYRJE

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin e Procedurës Penale, Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara në ligj. Bazuar në nenin 149 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvend për gjëndjen e kriminalitetit.

Struktura e raportit të Prokurorit të përgjithshëm përpara Kuvendit është e parashikuar shprehimisht në nenin 53 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar). Këtu, parashikohet se, raportimi përmban të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë si dhe drejtimit dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit.

Problemet e drejtësisë.

Edhe në vitin 2008 problemet dhe çështjet e drejtësisë kanë qenë në qendër të vëmendjes së përgjithshme. Reforma e thellë në sistemin e drejtësisë (prokurori dhe gjyqësor), disa procese të rëndësishme, disa vendime të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese, madje edhe të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore që kanë prekur tema vërtet të rëndësishme, kanë shkaktuar debate dhe polemika. Mjaft të lexosh pasqyrën shtypit ose të ndjekësh transmetimet e radio dhe të televizionit – të cilat ndonjëherë i kanë dhënë jetë thujse proceseve paralele me ato që zhvillohen në sallat gjyqësore - për ta konfirmuar.

Por, ndër problemet që është në qendër të debateve është ende ai i zgjatjes së proceseve, ngushtësisht e lidhur me sasinë e tyre. Është një interes dhe vëmendje e përgjithshme për të dhënë drejtësi sa më shpejt: bëhet fjalë për një interes konkret që i përket të gjithë atyre që vuajnë aktualisht mungesën e këtij "shërbimi" kaq të rëndësishëm, "shërbimit të drejtësisë".

Më 31 dhjetor 2008 kanë mbetur në hetim 4912 procedime –pothuajse 5000 (mijë)! Në qoftë se mbahet në konsideratë fakti se cdo proces penal mund të përfshijë një numër të konsiderueshëm personash si të pandehur ose palët e dëmtuara, sigurisht shifra e mësipërme do të rritet dhe menjëherë jepet tërësia e interesit - dhe e pakënaqësisë - që kanë qytetarët për derjtësinë. Duke mos përmendur këtu shpenzimet dhe kostot materiale, ankthin që proceset sjellin për sejcilin prej tyre.

Kuptohet se përse është e domosdoshme t'i japim jetë një sistemi drejtësie efikas, që lejon të kihet besim se gjithcka do të përfundojë në përputhje me ligjin dhe mundësisht shpejt. Tema e efikasitetit do të jetë motivi qëndror i këtij relatimi dhe parametri për të vlerësuar administrimin e drejtësisë në Shqipëri sot. Duhet të mbajmë në konsideratë se Europa na vendos në drejtim të cilësisë së juridiksionit, të organizimit dhe të efikasitetit në pozicione jo fort të përshtatshme karshi problemeve që duhen zgjidhur.

VOLUMI I PUNËS SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2008

Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Funkzioni i prokurorit duhet të ushtrohet në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokuroria si organ i pavarur punën e saj e bazon në parimin e pavarësisë kundrejt të gjithë pjesëmarrësve në procedurë penale si dhe organeve të tjera shtetërore.

Organet e prokurorisë janë:


- a) Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
- b) Prokuroria pranë gjykatës së apelit për Krime të Rënda;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të Apelit;
- ç) Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda;
- d) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

Gjatë viti 2008, në organet e prokurorisë janë regjistruar në total 17352 procedime penale, janë mbartur nga viti i kaluar 3344 procedime penale dhe janë rifilluar 582 procedime (në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda ose 84% e procedimeve

Nga prokuroritë pranë gjykatave të Apelit janë shqyrtuar në themel 2152 procedime penale dhe 1538 masa të sigurimit personal ose 15%.

Gjithashtu, pranë Gjykatës së Lartë janë ndjekur 273 raste nga ana e prokurorëve pranë Prokurorisë së Përgjithshme ose 1%. E kjo më së miri shihet në pasqyrimin grafik si më poshtë:


VOLUMI I PUNES I ORGANEVE TE PROKURORISE



Krahasuar me vitin 2007, në organet e prokurorisë janë regjistruar në total 15961 procedime penale, janë mbartur nga viti i kaluar 3094 procedime penale dhe janë rifilluar 655 procedime (në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda.

Nga prokuroritë pranë gjykatave të Apelit janë shqyrtuar në themel 2323 procedime penale dhe 1016 masa të sigurimit personal.


Gjithashtu, pranë Gjykatës së Lartë janë ndjekur 179 raste nga ana e prokurorëve pranë Prokurorisë së Përgjithshme.



Në analizë krahasuese të të dhënave të mësipërme të viteve 2007 dhe 2008 konstatohet një tendencë në rritje për procedimet penale në përgjithësi të rregjistruara përpara prokurorive të rretheve gjyqësore me një koeficient prej 0.079 ose e shprehur në përqindje evidentohet një tendencë në rritje prej 7.95% në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007. Me rritje të çështjeve të shqyrtuara themeli dhe të shqyrtimit të masave të sigurimit personal shfaqen edhe prokuroritë e Apeleve me një koeficient 0.105 ose e shprehur në përqindje, ka rritje të veprimtarisë së prokurorive të apeleve me 10.5% më shumë se në vitin 2007. Edhe në përfaqësimet pranë Gjykatës së Lartë vihet re e njëjta tendencë, pra ka një rritje të volumit të punës në këtë drejtim në vitin 2008 me një koeficient 0,525 ose e shprehur në përqindje, ka një rritje të volumit të punës pranë kësaj gjykate nga ana e organit të prokurorisë me 52,5% krahasuar me vitin 2007.

Më poshtë, paraqitet grafikisht volumi i punës i organit të prokurorisë për procedimet penale të rregjistruara në pesë vitet e fundit (2004-2008):

Procedime te Rregjistruara




Sikurse shihet edhe nga grafiku, volumi i punës i organit të prokurorisë ka ardhur gjithnjë në rritje. Kështu, në vitin 2005 vihet re një rritje të procedimeve penale të rregjistruara me 4 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje të rregjistrimit të procedimeve penale me 5 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje prej 11.2 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 8.7 për qind të procedimeve penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë.

Ky volum pune në rritje i organit të prokurorisë duket edhe në procedimet penale që janë në ndjekje penale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet “ndjekjen penale” në pesë vitet e fundit (2004-2008):

Ndjekje penale



Sikurse shihet edhe nga grafiku, procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë kanë ardhur gjithnjë në rritje. Kështu, në vitin 2005 vihet re një rritje të procedimeve në ndjekje penale me 6.8 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje të procedimeve në ndjekje penale me 5.8 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007

ka një rritje prej 9.7 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 8 për qind të procedimeve në ndjekje penale pranë organit të prokurorisë.

Shqipëria ka 9.7 prokurorë për 100.000 banorë si për vitin 2007 ashtu edhe për vitin 2008.


Ky volum pune është përballuar nga një numër prej 261 prokurorë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, 27 prokurorë pranë gjykatave të Apeleve dhe 19 prokurorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Duke konsideruar volumin e punës sipas niveleve të mësipërme rezulton se një prokuror pranë gjykatës së rrethit ka trajtuar mesatarisht për vitin 2007 – 75.52 çështje dhe në vitin 2008 – 81.52 çështje, pra një rritje prej 8% krahasuar me vitin 2007.

Për prokurorët e apeleve, në vitin 2007 – 123.67 çështje dhe në vitin 2008 – 136.67, pra një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2007 dhe prokurorët pranë Gjykatës së Lartë për vitin 2007 – 9.42 çështje mesatarisht për cdo prokuror dhe për vitin 2008 – mesatarisht 14.37 çështje për cdo prokuror, pra një rritje prej 53% krahasuar me vitin 2007.

Ne nivel kombëtar, për të gjitha nivelet e organit të prokurorisë del se cdo prokuror ka trajtuar mesatarisht në vitin 2007 – 75,66 çështje dhe në vitin 2008 – 82.22 çështje ose e shprehur në shifra relative kemi një rritje 9%.

MBI ÇËSHTJET E HETUARA

Nga shqyrtimi i të dhënave statistikore për pesë vitet e fundit (2004 – 2008), lidhur me çështjet për të cilat është përfunduar hetimi nga organi i prokurorisë, rezulton se:




Nga tabela e mësipërme vihet re se në vitin 2004 çështjet të cilat i janë **dërguar gjyqit** zënë 43.4 për qind të procedimeve penale për të cilët është përfunduar hetimi. Në vitin 2005

dhe në vitin 2006 kjo përqindje është e njëjtë, afërsisht 37. 4. Në vitin 2007 ky tregues zë 36.6 për qind të procedimeve të përfunduara dhe në vitin 2008 zë 39 për qind të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale për të cilat ka përfunduar hetimi.

Nga tabela e mësipërme vihet re se në vitin 2004 çështjet për të cilat është vendosur **pushimi** i procedimit penal nga prokurori, zënë 22.1 për qind të totalit të procedimeve penale për të cilët është përfunduar hetimi. Në vitin 2005, 24.7 për qind; në vitin 2006 dhe në vitin 2007 kjo përqindje është e njëjtë, përkatësisht 27. 4 dhe 27.8 për qind të procedimeve të përfunduara dhe në vitin 2008 zë 24 për qind të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale për të cilat ka përfunduar hetimi.

Pezullimi, në vitin 2004 përbënte 21.2 për qind të totalit të procedimeve për të cilat është përfunduar hetimi; në vitin 2005 kjo përqindje është 25.1; në vitin 2006 është 23 për qind pesha specifike që zënë çështjet për të cilat është vendosur pezullimi nga prokurori në vitin 2007 pesha specifike është 24.3 për qind dhe në vitin 2008, çështjet për të cilat është vendosur pezullimi zënë një peshë specifike prej 26 përqind të totalit të procedimeve të përfunduara.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake.



Nga shqyrtimi i të dhënave statistikore për vitin 2008 krahasuar vitin 2007, lidhur me çështjet e hetuara nga organi i prokurorisë rezulton se:

VITI	Cështje të regjistruara	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar
2007	15961	5850	4745	4317
2008	17352	6497	4235	4647


Të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2008 ka qënë 17352 çështje, nga 15961 që kanë qënë në vitin 2007, pra ka një rritje me 1391 çështje cka flet për rritje të volumit të punës që kanë përballuar prokuroritë e rretheve. Sic shihet edhe nga tabela, rezulton se numri i çështjeve të dërguara ne gjyq për vitin 2008 ka nje rritje prej 647 ceshtje krahasuar me vitin paraardhës. Në lidhje me çështjet e pushuara konstatohet se janë pushuar nga organi I prokurorisë 4235 ceshtje ose 510 më pak se vitin e kaluar, pra kemi nje tendencë për ulje të numrit të çështjeve te pushuara nga ana e organit të prokurorisë, c'ka është një tregues pozitiv nga pikëpamja statistikore, por që nuk lidhet me cilësinë e punës së organit të prokurorisë, ndërkohë që kemi rritje të numrit të çështjeve të pezulluara.

Duke marrë në konsideratë volumin e punës së organeve të prokurorisë gjate viteve 2007 dhe 2008 (duke konsideruar volum ceshtje te mbartura, të regjistruara dhe te rifilluara) dhe çështjet e dërguara ne gjykatë del se në vitin 2007 volumi i punës ka qënë 19710 çështje dhe 6531 prej tyre i janë dërguar gjykatës, në shifra relative do të thotë se 33% e tyre i janë dërguar gjyqit. Në vitin 2008 ka rritje të volumit të punës të organit të prokurorisë dhe kjo rritje ka sjelle në 21278 çështje nga të cilat 7033 i janë dërguar gjyqit të cilat përbëjnë 33% të volumit të punës, pra në shifra realtive jemi në të njëjta pozita sikurse në vitin 2007. Parë në periudhë pesëvjecare, sa më sipër është si më poshtë:

Për vitin 2004 rezulton se nga 15905 procedime penale që përbëjnë volumin e punës së organit të prokurorisë, i janë dërguar gjyqit 6545, ose 41% e tyre dhe nga këto vetëm 1% rezulton kthim aktesh nga gjykata. Për vitin 2005 rezulton se nga 16987 procedime penale që përbëjnë volumin e punës së organit të prokurorisë, i janë dërguar gjyqit 5846, ose 34% e tyre dhe nga këto vetëm 1% rezulton kthim aktesh nga gjykata. Për vitin 2006 rezulton se nga 17965 procedime penale që përbëjnë volumin e punës së organit të prokurorisë, i janë dërguar gjyqit 6158, ose 34% e tyre dhe nga këto vetëm 1% rezulton kthim aktesh nga gjykata.

Sa më sipër e paraqet grafiku i mëposhtëm.

Ceshtje derguar gjyqit dhe kthim aktesh nga gjykata



Një tregues cilësor i punës së organit të prokurorisë ka të bëjë me numrin e të pandehurve të dërguar gjyqit. Kështu:


VITI	Të pandehur dërguar gjyqit	Marrë pafajësi
2007	7033	174
2008	8184	184
	1151(16%)	10 (6%)

Nga tabela e mësipërme rezulton se kemi një rritje prej 16% të të pandehurve që i janë dërguar gjyqit nga ana e prokurorisë, ndërkohë që kemi një rritje vetëm 6% të të pandehurve që kanë marrë pafajësinë me vendim gjykate. Duke marrë këtu në konsideratë edhe numrin në rritje të procedimeve, arrijmë në konkluzionin e një pune cilësore të organit të prokurorisë për vitin 2008.


Ne pese vitet e fundit, për të njëjtit tregues shohim se:

VITI	Të pandehur dërguar gjyqit	Marrë pafajësi	
2004	7276	206	3%
2005	6266	219	3%
2006	6864	176	3%
2007	7033	174	2%
2008	8184	184	2%

Të pandehur dërguar gjyqit



Marrë pafajësi



Nga grafikët dhe tabelat e mësipërme rezulton se krahas rritjes së numrit të ceshtjeve ka edhe rritje të numrit të pafajësive, por vihet re në shifra relative në dy vitet e fundit nuk ka ndryshim dhe kundrejt tre viteve të mëparshëm kemi vetëm 1% ulje të rasteve të pafajësive të dhëna nga gjykata.

viti	derggjyqit	pushim akuze	pushim ceshtje
2007	5850	22	855
2008	6497	35	194
		13	-661

Në lidhje me mënyrën se si kanë përfunduar çështjet e dërguara nga organi i prokurorisë në vendimet e gjykatës theksojmë se duke krahasuar vitin 2007 me vitin 2008 për pushimin e akuzes nga gjykata ka një rritje të pandjeshme prej 0,5%, ndërsa për çështjet e pushuara kemi një ulje të ndjeshme prej 11.63% në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007. Ky është një tregues i cilësisë së punës së organit të prokurorisë.

MOSFILLIMET


Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në cdo kallëzim të bërë nga subjektet parashikuara nga nenet 281 e vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementet e veprave penale, prandaj me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në këto raste të vendosi mosfillimin e procedimit penal.

Ky tregues i punës, i parë edhe si mjet për të evituar hetimet e panevojshme mbi bazën e kallëzimeve të pabazuara, ka pësuar rritje këtë vit në krahasim me vitin kaluar. Kështu, ndërsa në vitin 2007 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 4075 kallëzime, në vitin 2008 janë marrë 4631 vendime të tilla.

Natyrisht, të dhënat statistikore në drejtim të numrit të mosfillimeve nuk janë gjithcka nëse ato nuk janë të bazuara në ligj e në prova. Gjithësesi, mosfillimet e bazuara në ligj e në prova përbëjnë një tregues që parandalon hetime të panevojshme dhe krijon mundësinë për përqëndrimin e forcave të punës në çështje të rëndësishme. Prandaj, në të ardhmen duhet të rritet kujdesi në verifikimin e kallëzimeve dhe profesionalizmi në gjykimin e tyre, duke marrë vendime të arsyetuara për mosfillimin e procedimit penal vetëm në rastet kur vërtetohet ekzistenca e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit

Grafiku i mëposhtem paraqet dinamikën e këtij treguesi në pesë vitet e fundit (2004-2008):

Procedime të mosfilluara




Ne lidhje me shtrirjen gjeografike të procedimeve penale, të dhënat tregojnë se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tirane, janë rregjistruar 4219 procedime penale ose 24.3 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Durrësi, janë rregjistruar 1676 procedime penale ose 9.7 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Elbasan, janë rregjistruar 1276 procedime penale ose 7.4 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Vlorë, janë rregjistruar 1223 procedime penale ose 7 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Korçë, janë rregjistruar 1107 procedime penale ose 6.4 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Shkodër, janë rregjistruar 1060 procedime penale ose 6.1 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Fier, janë rregjistruar 806 procedime penale ose 4.6 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Gjirokastër, janë rregjistruar 663 procedime penale ose 3.8 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Lezhë, janë rregjistruar 506 procedime penale ose 2.9 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Sarandë, janë rregjistruar 491 procedime penale ose 2.8 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Kukës, janë rregjistruar 475 procedime penale ose 2.7 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Berat, janë rregjistruar 468 procedime penale ose 2.7 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Lushnje, janë rregjistruar 412 procedime penale ose 2.4 për qind të totalit të procedimeve

të rregjistruara në shkallë republike; Dibër, janë rregjistruar 373 procedime penale ose 2.1 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Pogradec, janë rregjistruar 362 procedime penale ose 2 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Kavajë, janë rregjistruar 352 procedime penale ose 2 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Kurbin, janë rregjistruar 1676 procedime penale ose 1.9 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Krujë, janë rregjistruar 305 procedime penale ose 1.75 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Mat, janë rregjistruar 205 procedime penale ose 1.2 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Pukë, janë rregjistruar 144 procedime penale ose 0.8 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Tropojë, janë rregjistruar 110 procedime penale ose 0.6 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; Krimet e Rënda janë rregjistruar 100 procedime penale ose 0.6 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike.

Grafiku i mëposhtem paraqet volumin e punës sipas rretheve për vitet 2007-2008:

Volumi i punes sipas rretheve 2007-2008



KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 547.37, **është në rritje** në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2007 ishte 506.28.

Koeficientët e kriminalitetit sipas strukturës së Kodit Penal:

Për kreun e II-të të Kodit Penal “Vepra penale kundër personit, krime kundër jetës”,

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 71.03, **(ka ardhur në ulje)** dhe për vitin 2007 ishte 77.

Seksioni i I-rë “Krime kundër jetës të kryera me dashje” kanë tendence. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 24.26 **(ka ardhur në ulje)** dhe për vitin 2007 ishte 26.26.

Seksioni i V-të “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërpreja e shtatzanisë ose mosdhenia e ndihmës” kanë tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 9 **(ka ardhur në ulje)** dhe për vitin 2007 ishte 11.

Seksioni i VI-të “Krime seksuale” kanë tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 2.4 **(ka ardhur në ulje)** dhe për vitin 2007 ishte 3.2.

Për kreun e III-të të Kodit Penal “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”,

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 283 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 245.2.

Seksioni i I-rë “Vjedhja e Pasurisë” ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 165.8 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 140.

Seksioni i II-të "Mashtimet" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 15.8 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 12.8.

Seksioni i V-të "Krime në fushën e doganave" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 7.6 **(ka ardhur në ulje)** dhe për vitin 2007 ishte 11.

Seksioni i VIII-të "Falsifikimi i dokumenteve" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 55 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 44.9.

Seksioni i X-të "Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 3.4 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 0.4.

Për kreun e VIII-të i Kodit Penal "Krime kundër autoritetit të shtetit",

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 152 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 133.

Seksioni i I-rë "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryer nga shtetasit" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 19.4 **(ka ardhur në ulje)** dhe për vitin 2007 ishte 20.

Seksioni i II-të "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 22 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 13.


Seksioni i III-të "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 97.5 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 90.

Seksioni i IV-të "Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë" ka tendencë. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 13 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 9.

Për kreun e IX-të i Kodit Penal "Vepra penale kundër drejtësisë",

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 është 7 **(ka ardhur në rritje)** dhe për vitin 2007 ishte 6.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Seksioni i I-rë i kreut të tretë, “Vjedhja e Pasurisë” zë edhe vendin kryesor në kriminalitetin në vënd. I ndjekur më pas nga Seksioni i I-rë i kreut të tetë, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryer nga shtetasit” dhe Seksioni i VIII-të i kreut të tretë “Falsifikimi i dokumenteve” zënë vendin më të madh në kriminalitetin në shkallë vendi.

TË DHËNA PËR KRIMINALITETIN, DINAMIKËN DHE SHPËRNDARJEN E TIJ

I. VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT, KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE (NENET 76-84):

të dhënat tregojnë se procedimet penale të ndjekura janë si më poshtë:

i) 391 procedime të regjistruara për veprën penale të kanosjes, me 236 persona të marrë si të pandehur dhe 165 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 451 procedime me 288 persona të marrë si të pandehur dhe 57 të dënuar ose me ulje prej 15 për qind të procedimeve dhe 22 për qind e personave të marrë si të pandehur por me rritje prej 65 për qind të dënuarve;

ii) 251 procedime të regjistruara për veprën penale të vrasjes me dashje, me 133 persona të marrë si të pandehur dhe 97 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 274 procedime me 164 persona të marrë si të pandehur dhe 85 të dënuar ose me ulje prej 9 për qind të procedimeve të regjistruara dhe 23 për qind të personave të marrë të pandehur por me rritje prej 12 për qind të dënuarve;

iii) 77 procedime të regjistruara për veprën penale të vrasjes me paramendim, me 52 persona të marrë si të pandehur dhe 68 të dënuar (përfshirë dhe ata të mbartur në gjykim), ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 65 procedime me 48 persona të marrë si të pandehur dhe 53 të dënuar ose me rritje prej 16 për qind të procedimeve të regjistruara, 8 për qind të personave të marrë si të pandehur dhe 22 për qind të dënuarve;

iv) 31 procedime të regjistruar për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese, me 27 persona të marrë si të pandehur dhe 29 të dënuar (përfshirë dhe ata të mbartur në gjykim), ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 27 procedime me 30 persona të marrë si të pandehur dhe 26 të dënuar ose me rritje prej 13 për qind të procedimeve të regjistruara dhe 10 për qind të dënuarve por me ulje prej 11 për qind e personave të marrë si të pandehur;

Tabela paraqet në mënyrë të përmblodhur të dhënat si më poshtë:

VP kunder Personit	2007						2008			
	Nr. Proc. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja	274	100	164	115	85	251	125	133	143	97
Neni 77 Vrasja për një	0	0	0	0	2	1	0	0	0	2

krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendum	65	46	48	61	53	77	38	52	49	68
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	27	18	30	22	26	31	25	27	33	29
Neni 81 Vrasja e foshnjës	1	1	0	1	1	3	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	1	0	1	0	0	5	8	5	10	7
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	2	2	2	2	1	1	2	1	2	1
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	2	2	1	1	1	1	1	1	1	0
Neni 84 Kanosja	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Totali	828	361	540	409	313	769	355	461	444	372

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2008 ka një ulje prej 7% numrit të procedimeve të rregjistruara për krime kundër personit në krahasim me vitin 2007. Ndërkaq kemi një ulje prej 2% (për qind) të procedimeve të derguara për gjykim në krahasim me vitin 2007, tregues i cili tregon për një ulje (megjiëse e pakët) e cilësisë së punës të organit të prokurorisë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar perkundrejt këtij totali në vitin 2007 prej 15%(për qind) dhe një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 9% dhe kemi një rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 19%(për qind) perkundrejt vitit 2007, tregues cilësor i punës së organit të prokurorisë. Tregues tjetër i rëndësishëm ka të bëjë edhe me numrin e të pandehurve të dënuar në raport me numrin e të pandehurve të cilët janë dërguar për gjykim. Nga të dhënat statistikore del se 84%(për qind) e të pandehurve të dërguar për gjykim janë dënuar nga gjykata. Po ky tregues për vitin 2007 rezultojnë të jetë 77% (rritje prej 7%). Gjë që do të thotë për një punë më të mirë të organit të prokurorisë për vitin 2008.

TE PANDEHURIT

Ne lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2008 në total janë 525 të pandehur nga të cilët 28 janë të pandehur të mitur(meshkuj), 489 të pandehur meshkuj, janë të rritur (mbi 18 vjec) dhe 8 femra. Në këtë grup veprash penale rezultojnë i pandehur edhe një (1) shtetas i huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se 392 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar dhe 122 me arsim të mesëm dhe 8 me arsim të lartë.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga janë 10 nepunes të thjeshte shtetëror, 1 nepunes i nivelit të mesëm, sektori privat janë 81 të pandehur dhe të papunë 342 të papunë. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezultojnë se 268 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 245 prej tyre në komuna. Pra tendeca është pothuajse e njëjtë si për zonat urbane ashtu edhe në zonat rurale.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë (492 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 27 janë përsëritës për vepra penale të ndryshme. Viktima të dëmtuar të këtë grup veprash penale rezultojnë 15 meshkuj të mitur (mosha 14-18 vjec) dhe gjithsej 180 meshkuj madhorë, ndërsa 19 janë femra. Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 208 vdekje, 65 plagosje e rëndë dhe 43 plagosje e lehtë.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 26.26 ndërsa për vitin 2008 është 24.26. Edhe në këtë rast është e qartë tendenca për një ulje edhe të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.


E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 5% për vitin 2007 dhe 4% për vitin 2008 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje prej 1% në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për një rritje të veprës penale të Vrasjes me Paramendim të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal me 18% në krahasim me vitin 2007. Rritja e mësipërme del nga krahasimi i vlerave absolute të rasteve në referencë, por në një llogaritje për 100.000 banorë, kjo rritje është e papërfillshme. Kështu, për Vrasjen me Paramendim, në vitin 2007 koeficienti i kriminalitetit ishte 2.05 krime për 100.000 banorë, në vitin 2008 koeficienti i kriminalitetit është 2.42 krime për 100.000 banorë. (kjo quhet shifra relative e intensitetit që përbëhet nga, shifra raportuese, që në këtë rast shpreh nivelin e fenomenit, ndërsa emëruesi shpreh nivelin e fenomenit në ambientin ku zhvillohet ky fenomen).

Shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale është e tillë që Shkodra ka peshën specifike më të madhe përkundrejt totalit të kësaj vepre penale të procedimeve të rregjistruara në shkallë Republike, zë 22 përqind, Lezha dhe Tirana zënë 11 për qind, Elbasani 10 për qind dhe Durrësi me Fierin zënë 9 për qind, Dibra dhe Korçë 6 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale. Theksojmë se në nëndarjen "Të tjerë" janë përfshirë rrethet (Krujë me 2 procedime, Tropojë, Vlorë dhe Kukës me nga 3 procedime).

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale. Theksojmë se rrethet të cilat nuk janë paraqitur në grafik kanë patur një numër të ulët të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale (nga 0-2 procedime penale të rregjistruara).



Neni 78 Vrasja me Paramendim, paragrafi i parë, nga të dhënat statistikore rezultojnë gjithsej 68 procedime penale të rregjistruara për vitin 2008. Po kjo vepër penale e kryer:

- për interes 2 procedime penale të rregjistruara
- për hakmarrje 4 procedime penale të rregjistruara
- për gjakmarrje 3 procedime penale të rregjistruara.

Kuptohet që vrasje me paramendim për hakmarrje dhe gjakmarrje zënë peshën specifike më të madhe, brënda paragrafit të dytë të nenit 78.


Në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në shkallë Republike, vrasja me paramendim për interes zë 2,6 për qind dhe shtrihet gjeografikisht në Tiranë dhe Vlorë me nga një procedim penal të rregjistruar.

Vrasja me paramendim për hakmarrje zë 5,2 për qind përkundrejt totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale. Rezulton që gjeografikisht të jetë e pranishme në rrethet Durrës, Vlorë me nga një procedim të rregjistruar dhe në Shkodër 2 procedime penale.

Vrasja me paramendim për gjakmarrje zë 3,9 për qind përkundrejt totalit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale. Rezulton e pranishme në rrethet Kukës 1 procedim penal dhe në Shkodër 2 procedime penale.

Ecuria e kesaj vepre penale ne pese vite 2004-2008 paraqitet ne grafikun e meposhtem (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë.

Neni 78 Vrasja me paramendim



Duke interpretuar grafikun e mësipërm, në vitin 2005 duke u krahasuar me vitin 2004 kemi një tendencë në ulje të kriminalitetit që lidhet me këtë vepër penale prej 12.4 për qind. Në vitin 2006 ka përsëri një tendencë në rënje të këtij kriminaliteti prej 16.7 për qind krahasuar me vitin 2005 dhe në vitin 2008 vihet re një tendencë në rritje në masën 18.5 për qind në krahasim me vitin 2007.

TE PANDEHURIT


Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2008 në total janë 89 të pandehur nga të cilët 5 (pesë) janë të pandehur të mitur, gjinia meshkuj (mosha 14-18 vjec), 84 të pandehur meshkuj, janë të rritur (mbi 18 vjec). Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se 76 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar dhe 11 me arsim të mesëm dhe 1 me arsim të lartë. Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë 11 të pandehur dhe të papunë 60 të papunë. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 39 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 48 prej tyre në komuna. Pra tendeca kryesisht vjen nga zonat rurale.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë (85 të pandehur) ndërsa vetëm 2 prej tyre janë përsëritës.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale rezultojnë 6 meshkuj të mitur (mosha 14-18 vjec) dhe gjithsej 47 meshkuj madhore, ndërsa 5 janë femra. Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 57 vdekje, 21 plagosje e rëndë dhe 1 plagosje e lehtë.

Te dhena per te pandehurit, neni 78




Për veprën penale Vrasje në rrethana cilësuese parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal, vihet re një tendencë në rritje në krahasim me vitin 2007 prej 15% .

Për veprën penale Vrasje në rrethana cilësuese, për vitin 2007 koeficienti i kriminalitetit ishte 0.85 krime për 100.000 banorë dhe në vitin 2008 koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale është 0,98 krime për 100.000 banorë.

Shpërndarja gjeografike për këtë vepër penale paraqitet në vitin 2008 e tillë që kjo vepër penale është më shumë e përqëndruar në rrethet: Tiranë 16 përqind, Elbasani 13 për qind, Kurbin, Shkodër, Lushnje dhe Durrës me 10 për qind të totalit të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale. Me 6 përqind paraqiten Pogradeci dhe Vlora.

Sa më sipër do të gjeni grafikisht më poshtë. Theksojmë se në nëndarjen “të tjerë” janë paraqitur të grupuar rrethe të cilët nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale ose kanë rregjistruar vetëm një të

Neni 79, Vrasja ne Rrethana te Tjera Cilesuese,
Viti 2008




tillë.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal, Vrasja në rrethana të tjera cilësuese, shkronja "ç", (vrasja me dashje e kryer ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse), gjatë vitit 2008 janë rregjistruar gjithsej 3 procedime penale, përkatësisht, 1 procedim në rrethin Kavajë dhe 2 procedime në rrethin e Tiranës. Vihet re një tendencë në rritje në vitin 2008 për këtë vepër penale. Kështu, ndërsa në vitin 2007 nuk kemi asnjë procedim të rregjistruar për këto vepër penale, në vitin 2008 kemi gjithsej 3 procedime penale të rregjistruara.

Pesha specifike që zënë procedimet e rregjistruara për vrasja në rrethana të tjera cilësuese (shkronja c, ndaj deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, policit, ushtarakut, funksionarët e tjerë publikë gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura) është 13%, ndërsa pesha specifike që zë vrasja me dashje e kryer ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse, zë 9.7 për qind.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë).

Neni 79 Vrasja ne rrethana te tjera cilesuese




Duke interpretuar grafikun e mësipërm themi se në vitin 2005 duke u krahasuar me vitin 2004 kemi një tendecë në ulje të kriminalitetit që lidhet me këtë vepër penale prej 11.1 për qind. Në vitin 2006 ka përsëri një tendencë në rënie të këtij kriminaliteti prej 18.8 për qind krahasuar me vitin 2005, në vitin 2007 tendeca në rënie është edhe më e thelluar në një masë prej 30.8 për qind krahasuar me vitin 2006. Në vitin 2008 vihet re tendeca në rritje në masën 14.8 për qind në krahasim me vitin 2007.

Të PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 32 të pandehur nga të cilët dy janë të pandehur të mitur gjinia meshkuj (mosha 14-18 vjec), 30 të pandehur janë të rritur (mbi 18 vjec) përkatësisht 29 meshkuj dhe 1 femër. Një është shtetas i huaj nga këta të pandehur. Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se 26 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar dhe pesë me arsim të mesëm. Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton re se 1 (një) i pandehur është nëpunës i thjeshtë, nga sektori privat 4 të pandehur dhe të papunë 23 të pandehur. Pra, konkluzioni është se një nga faktorët kriminogjenë që ndikon në ecurinë e kësaj vepre penale ka të bëjë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë. Rezulton se 21 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 12 prej tyre në komuna. Pra tendeca kryesisht vjen nga zonat urbane. Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë (28 të pandehur) ndërsa vetëm 4 prej tyre janë përsëritës.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale rezulton një i mitur (mosha 14-18 vjec) dhe gjithsej 32 madhorë. Nga këta, 27 prej tyre janë meshkuj ndërsa 5 janë femra. Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 22 vdekje, 7 plagosje e rëndë dhe 14 plagosje e lehtë.


Te dhena per te pandehurit Neni 79



II. NE LIDHJE ME VEPRËN PENALE TË VRASJES NGA PAKUJDESIA (NENI 85)

janë regjistruar 23 procedime me 16 persona të marrë si të pandehur dhe 7 të dënuar, ndërsa për vitin 2007, janë regjistruar 29 procedime me 11 persona të marrë si të pandehur dhe 10 të dënuar ose me ulje prej 26 për qind të procedimeve të regjistruara dhe 42 për qind e të dënuarve por me rritje prej 31 për qind e personave të marrë si të pandehur.


Neni 85 Vrasja nga pakujdesia



Grafiku i mësipërm paraqet numrin e procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, vrasja nga pakujdesia. Rezulton se rrethet Durrës, Fier, Korçë, Krujë Kukës, Tropojë dhe Vlorë janë rregjistruar vetëm 1

procedim penal për këtë vepër penale, të cilat zënë 4 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.


Rrethet Berat, Dibër, Elbasan, Lezhë, Lushnje dhe Shkodër kanë rregjistruar 2 procedime penale dhe zënë secili 9 për qind të procedimeve penale të rregjistruara. Tirana ka rregjistruar 4 procedime penale dhe zë 18 për qind të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në shkallë republike.



Dinamika e kësaj vepre penale për pesë vitet e fundit (2004-2008) flet në përgjithësi për një qëndrueshmëri relative. Kështu, në vitin 2005 vihet re një tendencë në rritje prej 10.3 për qind në krahasim me vitin 2004, në vitin 2006 kemi një ulje prej 25% të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 vihet re një rritje prej 20.8 për qind të procedimeve të rregjistruara në organin e prokurorisë në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 vihet re një ulje prej 20.7 për qind në krahasim me vitin 2007.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 85 Vrasja nga Pakujdesia



III. VEPRAT PENALE TË KRYERA ME DASHJE KUNDËR SHËNDETIT (NENET 86-90)

të dhënat tregojnë se procedimet penale të ndjekura janë si më poshtë:

i) 655 procedime të regjistruara për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje, me 481 persona të marrë si të pandehur dhe 204 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 659 procedime me 438 persona të marrë si të pandehur dhe 127 të dënuar ose me ulje prej 0, 6 për qind të procedimeve të regjistruara por me rritje prej 9 për qind të personave të marrë si të pandehur dhe 38 për qind e të dënuarve;

ii) 112 procedime të regjistruara për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, me 99 persona të marrë si të pandehur dhe 64 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 115 procedime me 108 persona të marrë si të pandehur dhe 70 të dënuar ose me ulje prej 2,6 për qind të procedimeve të regjistruara, 9 për qind të personave të marrë si të pandehur dhe 9 për qind e të dënuarve;

iii) **Në lidhje me veprën penale të torturës** gjatë vitit 2008 është regjistruar vetëm një procedim penal por asnjë person nuk është marrë i pandehur ose është dënuar. Gjatë vitit 2007 janë regjistruar 3 procedime penale por asnjë person nuk është marrë i pandehur ose është dënuar në lidhje me këtë vepër penale.

iv) 16 procedime të regjistruara për veprën penale dëmtime të tjera me dashje, me 9 persona të marrë si të pandehur dhe 2 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 32 procedime me 21 persona të marrë si të pandehur dhe 4 të dënuar ose me ulje me 2 herë të procedimeve të regjistruara dhe të dënuarve. .

Tabela paraqet në mënyrë të përmblodhur të dhënat si më poshtë:

V.P. K/shëndetit me dashje	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denuar
Neni 86 Tortura	274	100	164	115	85	251	125	133	143	97
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda	0	0	0	0	2	1	0	0	0	2
Neni 88 Plagosje e rëndë	115	80	108	88	70	112	82	99	94	64
Neni 88/a Plagosje e rëndë tronditje psikike	2	1	1	1	4	10	6	10	7	6
Neni 88/b P.R. në kapërcim të mbrojtjes	2	1	1	1	3	2	5	2	6	3
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	659	216	438	264	127	655	261	481	333	204
Neni 90 Dëmtime të tjera	32	3	21	6	4	16	4	9	7	2
Totali	813	301	659	360	208	796	358	601	447	279

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2008 ka një ulje prej 2% numrit të procedimeve të rregjistruara për krime kundër shëndetit me dashje në krahasim me vitin 2007. Ndërkaq kemi një rritje prej 19% (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2007, tregues i cili tregon për rritjen e cilësisë së punës të organit të prokurorisë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar kundërshtuar këtij totali në vitin 2007 prej 9%(për qind) dhe një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 24% dhe kemi një rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34%(për qind) përkundërshtuar vitin 2007. Tregues tjetër i rëndësishëm ka të bëjë edhe me numrin e të pandehurve të dënuar në raport me numrin e të pandehurve të cilët janë dërguar për gjykim. Nga të dhënat statistikore del se 62%(për qind) e të pandehurve të dërguar për gjykim janë dënuar nga gjykata. Po ky tregues për vitin 2007 rezulton të jetë 58% (rritje prej 4%). gjë që do të thotë për një punë më të mirë të organit të prokurorisë për vitin 2008.

Veprat penale kundër shëndetit me dashje, për 100.000 banorë janë 25.8 në vitin 2007 dhe 25.11 në vitin 2008 ose e shprehur në përqindje për të dy vitet, ky grup veprash penale zë 5.1 % të numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike për vitin 2007, ndërsa për vitin 2008 specifike e këtij grupi veprash penale përkundërshtuar totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike është 4.6 për qind, pra tendenca është në rënie për vitin 2008.

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale gjatë vitit 2008 në total janë 490 të pandehur, nga të cilët 40 të mitur meshkuj, 429 të pandehur meshkuj madhorë (mbi 18 vjeç) kemi një ulje me 14.4 për qind të të pandehurve në krahasim me vitin 2007 dhe 21 të pandehur femra që do të thotë ulje me 58.9 për qind në krahasim me vitin 2007. Në lidhje me të miturit të pandehur vihet re një ulje prej 38.5 për qind në krahasim me vitin 2007, ndërsa madhorët, të pandehur, kanë një ulje me 16 për qind në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se 377 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, që do të thotë kemi një ulje me 9,4 për qind krahasuar me vitin 2007 për këtë kategori; 106 të pandehur janë me arsim të mesëm, që do të thotë ulje me 34.2 për qind në krahasim me vitin 2007 dhe 6 me arsim të lartë, pra ulje me 72.8 për qind në krahasim me vitin 2007.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të papunë janë 300 të pandehur, 85 janë nga sektori privat dhe 2 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë shtetërorë. Pra, faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e këtij grupi veprash penale ka të bëjë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 305 të pandehur kanë vendbanimin në qytet. Në krahasim me vitin 2007 vihet re një ulje prej 20.6 për qind. 184 të pandehur kanë vendbanimin në komunë, që do të thotë një ulje prej 15.2 për qind në krahasim me vitin 2007. Gjithësesi, tendenca kryesisht vjen nga zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë 457 nga të pandehurit në këtë grup veprash penale janë të padënuar më parë, 26 janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 3 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

Viktima të dëmtuar të këtij grupi veprash penale rezultojnë 8 të mitur meshkuj (mosha 14-18 vjeç), 146 madhorë, meshkuj dhe 11 femra.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 4 vdekje, 86 plagosje e rëndë, pra një rritje prej 43.3 për qind në krahasim me vitin 2007 dhe plagosje e lehtë 371, që do të thotë një ulje prej 20 përqind.

Në total, për të pandehur të përfunduar (të pandehur për çështje të pushuara, të pandehur për çështje të pezulluara dhe të pandehur për çështje të transferuara dhe të dërguara gjyqit)

TENDENCA

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rënie e procedimeve të rregjistruara përpara organit të akuzës për veprën penale të parashkuar nga **Neni 86 i Kodit Penal, Tortura**

Kjo rënie është në masën 8.4 për qind, në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale ne vitin 2007 ishte afërsisht 8.7 krime për 100.000 banorë, ndërsa në vitin 2008 është 8 krime për 100.000 banorë.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale kundër shëndetit të kryera me dashje ishte 33.7 për qind në vitin 2007 dhe është 31,5 për qind në vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale parë në pesë vite (2004-2008) paraqitet e tillë që në vitin 2005 kemi një ulje prej 80 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 kemi një rritje prej 100 për qind të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2005, në vitin 2007 kemi një rritje prej 50 për qind të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rënie prej 66.7 për qind të procedimeve të rregjistruara, në krahasim me vitin 2007.

Për vitin 2008 është rregjistruar vetëm një procedim penal për këtë vepër penale në prokurorinë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 86 Tortura



Ne lidhje me vepren penale te parashikuar nga Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjëndje të tronditjes së fortë psikike, ka një rritje 4 herë më shumë ne vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 të procedimeve të rregjistruara.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale ne vitin 2007 ishte afërsisht 0,06 krime për 100.000 banorë, ndërsa në vitin 2008 është 0,3 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale kundër shëndetit të kryera me dashje ishte 0.25 për qind në vitin 2007 dhe është 1,26 për qind në vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet e tillë:

Në vitin 2005 janë rregjistruar 10 procedime penale e njëjtë kjo shifër me atë të vitit 2004. Në vitin 2006 ka një ulje të ketij kriminaliteti me 50 për qind në krahasim me vitin 2005. Me ulje rezulton edhe viti 2007, ulje prej 60 për qind në krahasim me vitin 2006. Në vitin

2008 kemi një rritje rreth 4 herë të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2007. Rrethet ku janë rregjistruar këto procedime penale janë Fieri 8 procedime, Kavajë 1 procedim dhe Tirana 1 procedim penal. Në rrethet e tjera nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale.

Sa më sipër paraqitet në grafikët e mëposhtëm:


Neni 88/a Plagosje e rende ne gjendje te tronditje se forte psikike



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale theksojmë se vetëm në tre rrethe janë rregjistruar procedime penale. Kështu, rrethet Kavajë dhe Tiranë kanë rregjistruar vetëm një procedim penal gjatë vitit 2008 ose 10 për qind të procedimeve në shkallë vendi. Rrethi i Fierit ka rregjistruar 8 (tetë) procedime penale për këtë vepër penale ose 80 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 88/a Plagosje e rende ne gjendje te tronditjes se forte psikike



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 5 të pandehur, madhorë, meshkuj


Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se të pandehurit janë me arsim deri 9-vjecar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të papunë janë 5 të pandehur. Pra, konkluzioni është se një nga faktorët kriminogjenë që ndikon në ecurinë e kësaj vepre penale ka të bëjë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë. Rezulton se 4 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 1 në komunë. Pra tendeca kryesisht vjen nga zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të pestë të pandehurit për këtë vepër penale janë të padënuar më parë.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale rezulton nje i mitur (mosha 14-18 vjec) dhe 2 madhorë, meshkuj. Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 1 vdekje, 1 plagosje e rëndë.

Te dhena per te pandehurit Neni 88/a



Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga **Neni 90 dëmtime të tjera me dashje**, ka një ulje prej 50 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 të procedimeve të rregjistruara.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte afërsisht 1,015 krime për 100.000 banorë, ndërsa në vitin 2008 është 0,5 krime për 100.000 banorë.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale kundër shëndetit të kryera me dashje ishte 3.94 për qind në vitin 2007 dhe është 2.01 për qind në vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit paraqitet:

Në vitin 2005 ka një rritje prej 15.6 për qind të procedimeve të rregjistruara përkundrejt vitit 2004. Në vitin 2006 ka një rënie prej 2 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2005. Po me rënie paraqitet edhe viti 2007 në masën 37,3 për qind me pak procedime të rregjistruara në krahasim me vitin 2006. Së fundi, në vitin 2008 kemi sërish një rënie me 50 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2007.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 90 Demtime te tjera me dashje



Shpërndarja gjeografike për procedimet penale për këtë vepër penale paraqitet e tillë:

Dibra, Kukësi dhe Pogradeci kanë rregjistruar nga 2 procedime penale, ose e shprehur në përqindje 13 për qind. Durrësi, Tirana dhe Tropoja kanë rregjistruar nga 1 procedim penal, e shprehur në përqindje 6 për qind të procedimeve të rregjistruara në nivel republike. Fieri ka rregjistruar 3 procedime penale, ose e shprehur në përqindje 19 për qind dhe Elbasani 4 procedime penale ose 24 për qind. Rrethet e tjera nuk kanë asnjë procedim penal të rregjistruar për këtë vepër penale gjatë vitit 2008.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 5 të pandehur, madhorë, meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se të pandehurit janë 4 të pandehur me arsim deri 9-vjecar, 1 i pandehur me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të papunë janë 5 të pandehur. Pra, konkluzioni është se një nga faktorët kriminogjenë që ndikon në ecurinë e kësaj vepre penale ka të bëjë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë. Rezulton se 5 te pandehur jane me vendbanim në komunë. Pra tendeca kryesisht vjen nga zonat rurale.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të pestë të pandehurit për këtë vepër penale janë të padënuar më parë.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale rezulton një madhor, mashkull.

IV. Për veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës, (nenet 93-99)

Për veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës ka patur 347 procedime të rregjistruara në vitin 2007 dhe 286 procedime penale të rregjistruara për vitin 2008. Vihet re një ulje prej 17.6% të procedimeve penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007. Gjthashtu, kemi një rritje prej 25 % të procedimeve dërguar gjyqit, po me rritje prej 18% të të pandehurve dërguar gjyqit. Nga të pandehurit dërguar gjyqit kemi dyfishim të numrit të të dënuarve kundrejt

vitit 2007. Por, në vitin 2008, 31% e të pandehurve dërguar gjyqit janë dënuar nga gjykata përkundrajt 18% të të njëjtit tregues në vitin 2007. Pra vihet re një rritje prej 13% në vitin 2008 për treguesin e të pandehurve të cilet i janë dërguar gjyqit dhe që janë dënuar nga gjykata për këtë grup veprash penale.


Për këtë grup veprash penale, vihet re se për 100.000 banorë, në vitin 2007 ka patur 11 krime të këtij lloji dhe në vitin 2008, rezultojnë 9 të tilla.

Pesha specifike e këtij grupi veprash penale në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara përpara organit të prokurorisë për vitin 2007 ishte 2.17 për qind ndërsa për vitin 2008 rezulton të jetë 1.65 për qind.

Nga të dhënat statistikore vihet re se dy lloje veprash penale kanë tendenca specifike në këtë grup krimesh.

Kështu, mjekimi i pakujdesshëm, vepër penale e parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, ka një rritje prej 3% për vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara. Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale për 100.000 banorë për vitin 2007 ishte 0,5 ndërsa në vitin 2008 është 0,67. Pavarësisht se diferenca është e ulët në nivel republike, tendenca vihet re për këtë vepër penale.


Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë në pesë vitet e fundit (2004-2008) të kësaj vepre penale.



Në interpretim të grafikut theksojmë se për këtë vepër penale, në vitin 2005 vihet re një rënie e theksuar prej 66.7 për qind e procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 vihet re një rritje e ndjeshme në krahasim me vitin 2005 prej pothuajse 8 herë më shumë; në vitin 2007 kemi përsëri një rënie në masën 43 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 kemi një rritje prej 31,25 për qind në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale, sipas të dhënave statistikore rezulton se për këtë vepër penale jane rregjistruar:

Në Tiranë 12 procedime ose 56 për qind e procedimeve;
 Rrethet Lezhë, Shkodër dhe Elbasan kanë rregjistruar nga 2 procedime penale ose 10 për qind e procedimeve përkatesisht sejcila.
 Durrës, Kavajë dhe Pogradec kanë rregjistruar nga 1 procedim penal ose 5 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike. Rrethet të cilat mungojnë në grafik nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale.



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 15 të pandehur, nga të cilët 13 meshkuj madhorë dhe 2 femra madhore .


Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se të pandehurit janë të gjithë me arsim të lartë.

Rezulton se të 15 të pandehurit janë me vendbanim në qytet. Pra tendeca kryesisht vjen nga zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit për këtë vepër penale janë të padënuar më parë.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale rezultojnë dy meshkuj madhorë. Pasoja në dëm të shëndetit rezulton të jetë me 10 vdekje.

Te dhena per te pandehurit Neni 96




Shkaktimi i vetëvrasjes, vepër penale e parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, ka një ulje prej 3% në vitin 2008 duke e krahasuar me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale për 100.000 banorë për vitin 2007 ishte 10,3 ndërsa në vitin 2008 është 8,2. Vihet re tendeca në rënie për këtë vepër penale.

Dinamika në pesë vitet e fundit (2004-2008) për këtë vepër penale paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 99 Shkaktimi i vetvrasjes



Në vitin 2005 vihet re një tendencë në rritje prej 45,7 për qind të procedimeve të rregjistruara, në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 vihet re rritje prej 30 për qind të procedimeve të rregjistruara përkundrejt vitit 2005; në vitin 2007 përsëri tendenca është në rritje prej 14 për qind në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 vihet re një tendecë në ulje prej 19.9 për qind në krahasim me vitin 2007 të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale, vihet re përgjithësisht shpërndarje e saj në të gjithë territorin e vendit. Rrethet me numrin më të madh të procedimeve penale të rregjistruara janë Tirana me 41 procedime penale ose 16 për qind e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë republike; Elbasani ka rregjistruar 37 procedime penale ose 14 për qind të procedimeve; Korça me 36 procedime penale ose 14 për qind, Durrësi me 29 procedime penale ose 11 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara; Rrethet Fier, Kavajë dhe Lezhë kanë rregjistruar përkatësisht 20 dhe 19 procedime ose përkatësisht 8 dhe 7 për qind të procedimeve të rregjistruara. Në nënndarjen “të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar 1-4 procedime penale për këtë vepër penale.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 2 të pandehur, meshkuj madhorë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se të pandehurit janë të gjithë me arsim 9-vjecar.

Rezulton se 1 i pandehur është me vendbanim në qytet dhe një me vendbanim në komunë.

Rezulton se 1 i pandehur nga sektori privat dhe 1 pandehur i papunë.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të dy të pandehurit për këtë vepër penale janë të padënuar më parë.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale rezultojnë tre meshkuj të mitur, 59 meshkuj të rritur dhe 26 femra të rritura. Pasoja në dëm të shëndetit rezulton të jenë me 148 vdekje, 4 plagosje e rëndë dhe 1 plagosje e lehtë.

V. PËR KRIMET SEKSUALE

Sipas llojit të veprave penale në fushën e krimeve seksuale, të dhënat tregojnë se procedimet penale të ndjekura janë si më poshtë:

i) 23 procedime të regjistruara për veprën penale të “marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç” parashikuar nga neni 101 i KP, me 18 persona të marrë si të pandehur dhe 7 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 32 procedime me 19 persona të marrë si të pandehur dhe 1 të dënuar ose me ulje prej 39 për qind të procedimeve të regjistruara dhe 5,5 për qind të personave të marrë si të pandehur por me rritje të dënuarve;

ii) 23 procedime të regjistruara për veprën penale të “marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura” parashikuar nga neni 102 i Kdit Penal, me 15 persona të marrë si të pandehur dhe 5 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 37 procedime me 26 persona të marrë si të pandehur dhe 14 të dënuar ose me ulje prej 61 për qind të procedimeve të regjistruara, 73 për qind të personave të marrë si të pandehur dhe me 2,8 herë të dënuarve;

iii) 17 procedime të regjistruara për veprën penale të “marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të mitur” parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal, me 10 persona të marrë si të pandehur dhe 6 të dënuar, dhe për vitin 2007 ka numër të njëjtë procedimesh, të pandehurish dhe të dënuarish;

iv) 7 procedime të regjistruara për veprën penale “vepra të turpshme” parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal, me 5 persona të marrë si të pandehur dhe 5 të dënuar, ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 8 procedime me 6 persona të marrë si të pandehur dhe 12 të dënuar (përfshirë dhe të mbartur në gjykim), duke shënuar një rritje të dukshme të numrit të dënuarve për këtë vepër penale.

Tabela paraqet në mënyrë të përmbledhur të dhënat si më poshtë:

Krime Seksuale	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	17	10	13	10	6	17	10	10	10	6
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me 14-18 vjeç	32	7	19	8	1	23	9	18	9	7
Neni 102 M. Seksuale me dhunë	37	15	26	17	14	23	5	15	6	5
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë	2	1	2	1	0	2	1	2	1	1

Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë	2	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale shpërdorim detyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale ne gjini	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike	1	0	1	0	0	1	0	1	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	2	2	2	2	1	0	0	1	1	1
Totali	94	35	64	38	22	69	25	47	27	20

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2008 ka një ulje prej 16.6% numrit të procedimeve të rregjistruara për krime seksuale kundrejt vitit 2007. Ndërkaq kemi një ulje prej 18.57% (për qind) të procedimeve të derguara për gjykim në krahasim me vitin 2007, tregues i cili tregon për rënie të cilësisë së punës të organit të prokurorisë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2007 prej 16.56% (për qind) dhe një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 28.95% dhe kemi një ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 10%(për qind) përkundrejt vitin 2007. Tregues tjetër i rëndësishëm ka të bëjë edhe me numrin e të pandehurve të dënuar në raport me numrin e të pandehurve të cilët janë dërguar për gjykim.

Nga të dhënat statistikore del se 74%(për qind) e të pandehurve të dërguar për gjykim janë dënuar nga gjykata. Po ky tregues për vitin 2007 rezulton të jetë 58% (rritje prej 16%). gjë që do të thotë për një punë më të mirë të organit të prokurorisë për vitin 2008.

Veprat penale krime seksuale, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 3 në vitin 2007 dhe 2 në vitin 2008.


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale është 0,59% përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në rang Republike për vitin 2007 dhe 0.40 % për vitin 2008. Pra kemi një rënie prej 0.19% në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale, vihet re një tendencë në rënie të dy figurave të veprave penale për vitin 2008. Bëhet fjale për veprën penale Marrëdhënie Seksuale ose Homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjec (neni 101 i Kodit Penal), dhe për veprën penale Marrëdhënie Seksuale me Dhunë me të Rritura, të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal. Respektivisht kemi ulje me 28% dhe me 38% në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal ishte 1 për 100.000 banore në vitin 2007 dhe është 0.7 në vitin 2008, tendencë në rënie.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet dinamika e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në pesë vitet e fundit (2004-2008):



Edhe në grafik vihet re tendenca lehtësisht në ulje.


Kështu, në vitin 2005 vihet re një rritje prej 19 për qind e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 vihet re një tendencë në rënie të këtij treguesi, ulja është prej 12 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 kemi rritje prej 45.5 për qind të procedimeve të rregjistruara krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rënie prej 28 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal, Marrëdhënie Seksuale ose Homoseksuale me dhunë me të mitur të moshes 14-18 vjec.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal, Marrëdhënie Seksuale ose Homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjec, paraqitet si më poshtë:

Rrethet Durrës, Tiranë dhe Vlorë kanë rregjistruar nga tre procedime penale ose përkatësisht 14 për qind dhe 13 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në shkallë republike. Berati, Kavajë, Korçë dhe Tropojë kanë rregjistruar nga dy procedime penale ose 9 për qind secili prej tyre. Rrethet Dibër, Fier, Gjirokastër, Lezhë, Lushnje dhe Sarandë kanë rregjistruar nga një procedim penal ose katër për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

**Neni 101 Marredhenie seksuale ose homoseksuale me dhune
me te mitur te moshes 14-18 vjec**



TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 16 të pandehur, nga të cilët 4 meshkuj të mitur, 12 meshkuj madhorë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se të pandehurit janë 13 të pandehur me arsim deri 9-vjecar, 2 janë me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore një i pandehur nga sektori privat dhe 13 të pandehur të papunë (faktor kriminogjen është papunësia).

Rezulton se 11 të pandehur janë me vendbanim në qytet dhe 5 të pandehur janë me vendbanim në komunë. Pra tendenca kryesisht vjen nga zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 14 të pandehur për këtë vepër penale janë të padënuar më parë dhe dy prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale janë tre femra të mitura.

Koeficienti i kriminalitetit për vepren penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal ishte 1.2 për 100.000 banorë në vitin 2007 dhe është 0.7 në vitin 2008, tendence në rënie.

Dinamika e procedimeve të rregjistruara për këto vepra penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtem:


Neni 102 Marredhenie Seksuale me Dhune me te Rritura



Edhe ëe grafikun e mësipërm vihet re tendenca në rënie në vitin 2005 përkundrejt vitit 2004, prej 11.11 për qind; në vitin 2006 vihet re një tendencë në rritje të këtij treguesi, rritja është prej 6.3 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 kemi rritje prej 8.8 për qind të procedimeve të rregjistruara krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rënie prej 37,8 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal, Marrëdhënie Seksuale me dhunë me të rritura.

Shpërndarja gjeografike e procedimeve të rregjistruar për këtë veprë penale paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 102 Marredhenie seksuale me dhune me te rritura



në rrethin e Durrësit janë rregjistruar gjithsej 7 procedime penale ose 30 përqind e procedimeve në shkallë vendi. Në rrethin e Tiranës janë rregjistruar 3 procedime penale ose 13 për qind e procedimeve në shkallë vendi. Në rrethet Fier dhe Vlorë janë rregjistruar 2 procedime penale ose 9 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara në

shkallë republike. Në nëndarjen “të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar vetëm nga 1 procedim penal për këtë vepër penale.

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë vepër penale gjatë vitit 2008 në total janë 17 të pandehur, nga të cilët 3 meshkuj të mitur, 13 meshkuj madhorë dhe 1 femër madhore.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve vihet re se të pandehurit janë 14 të pandehur me arsim deri 9-vjecar dhe 3 janë me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nje i pandehur nga sektori privat dhe 15 të pandehur të papunë (faktor kriminogjen është papunësia).

Rezulton se 15 të pandehur janë me vendbanim në qytet dhe 2 të pandehur janë me vendbanim në komunë. Pra tendeca kryesisht vjen nga zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 15 të pandehur për këtë veper penale janë të padënuar më parë dhe dy prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Viktima të dëmtuar të kësaj vepre penale janë 1 femër e mitur dhe 4 femra madhore.

PËR VEPRAT PENALE TË TRAFIQEVE TË PALIGJSHME

Gjatë vitit 2008 janë regjistruar 335 procedime penale dhe 295 persona janë marrë si të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me ulje prej 2 për qind të procedimeve penale të regjistruara dhe 2 për qind të numrit të personave të marrë si të pandehur. 188 procedime janë dërguar për gjykim dhe është ngritur akuzë në gjykatë për 265 të pandehur dhe janë dënuar 258 të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 7 për qind të pandehurve të dërguar për gjykim dhe 12 për qind të pandehurve dënuar për këto vepra penale të rënda.

Në tabelën më poshtë, janë evidentuar procedimet e regjistruara për këto vepra penale për vitet 2007 dhe 2008.

Trafikimi QNj	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 110/a Trafikim i Personave	3	0	2	0	0	3	1	1	1	1
Neni 114/b Trafikimi i femrave	12	4	4	6	10	20	6	8	8	8
Neni 128/b Trafikimi i te miturve	3	4	2	7	3	5	6	3	7	4
Neni 138/a Trafikimi I veprave te artit dhe kultures	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	162	24	29	28	20	284	25	53	28	16
Neni 278/a Trafikimi i armeve dhe i municionit	35	31	53	49	28	33	31	48	56	29
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasuese, djegëse helmuese dhe radioaktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	44	28	51	82	73	65	26	100	69	15
Neni 298 Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit	207	98	169	132	130	221	112	206	170	153
Totali	466	189	310	304	264	631	207	419	339	226

Sipas llojit të veprave penale shifrat evidentojnë se në vitin 2008 procedimet penale të ndjekura, janë si më poshtë:

i) 3 procedime janë regjistruar për trafikim të personave dhe 1 person është marrë si i pandehur dhe 1 është dënuar. Ndërsa për vitin 2007, gjithashtu janë regjistruar 3 procedime dhe 2 persona janë marrë si të pandehur por asnjë i pandehur nuk është gjykuar dhe dënuar në gjykatë, neni 110/a;

ii) 5 procedime janë regjistruar për trafikim fëmijësh, dhe 3 persona janë marrë si të pandehur. 7 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe 3 janë dënuar. Ndërsa për vitin 2007, janë regjistruar 3 procedime dhe 2 persona janë marrë si të pandehur dhe janë dënuar 3 të pandehur (mbartur në gjykim), neni 128/b;

iii) 20 procedime janë regjistruar për trafikim të femrave, dhe 8 persona janë marrë si të pandehur dhe 6 procedime janë dërguar për gjykim. Janë dërguar për gjykim 8 të pandehur dhe janë dënuar 8. Ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 12 procedime dhe 4 persona janë marrë si të të pandehur dhe 4 procedime janë dërguar për gjykim. Janë dërguar për gjykim 6 të pandehur dhe janë dënuar 10 (përfshirë dhe ata të pandehur të mbartur në hetim dhe gjykim), neni 114/b;

iv) 221 procedime janë regjistruar për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit (kundrabanda e njerëzve), 206 persona janë marrë si të pandehur dhe 112 procedime janë dërguar për gjykim. 170 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar 153. Ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 207 procedime, 169 persona janë marrë si të pandehur dhe 98 procedime janë dërguar për gjykim. 132 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar 130.

Për këtë grup veprash penale (**TRAFIQET**), rezulton se koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë, në shkallë republike, për këtë grup veprash penale ka qenë 14.8 në vitin 2007 dhe 19.9 për vitin 2008 (ka ardhur në rritje).

Pra vihet re një tendencë në rritje për këtë kategori veprash penale. Dhe rritja në vitin 2008 ka qenë 35,4 % (për qind) në krahasim me vitin 2007.

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale, përkundrejt totalit të procedimeve (për këtë grup) në shkallë republike për vitin 2007 është 2,92%, ndërsa për vitin 2008 është 3,64% (për qind). Pra edhe në këtë këndvështrim vihet re tendenca në rritje e këtij lloji kriminaliteti.

Në lidhje me procedimet, nga të dhënat statistikore vihet re se vërtet kemi një rritje të numrit të tyre përkundrejt vitit 2007, por raporti i çështjeve të cilat i janë dërguar gjyqit, me ato çështje që janë rregjistruar është më i vogël. Kështu, në vitin 2007 i janë dërguar gjyqit 41% e procedimeve të rregjistruara dhe në vitin 2008 vetëm 33% e tyre. Ky është një tregues jo i mirë për organin e prokurorisë.

Në lidhje me të pandehurit, vihet re se për këtë kategori veprash penale për vitin 2007 87% e të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit janë dënuar ndërsa për vitin 2008, kjo e dhënë rezulton në ulje, pra 67% e të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit, janë dënuar nga gjykata, dhe ulja është 20% ndërmjet dy viteve (një e dhënë kjo jo e mirë për punën e organit të prokurorisë për kategori veprash penale). Ndërkohë rezulton se në rritje janë treguesit që kanë të bëjnë me rritje prej 35% të numrit të procedimeve të rregjistruara, rritje prej 10% të numrit të procedimeve që i janë dërguar gjyqit, rritje të numrit të pandehurve për këtë grup veprash penale të rregjistruar prej 35% nga këta 12% më shumë (në krahasim me vitin 2007) i janë dërguar gjyqit, por kjo shifër përbën 81% e të pandehurve të rregjistruar për vitin 2008, ndërkohë që për vitin 2007 kanë qenë 98% e të pandehurve të rregjistruar të cilët i janë dërguar gjyqit. (një tregues ky jo i mirë për punën e organit të prokurorisë).

TENDENCA

në këtë grup veprash penale vihet re tek veprat penale të parashikuara nga:

Neni 114/b Trafikimi i femrave; (në vlerë absolute vihet re një rritje e numrit të procedimeve të rregjistruara në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007, por që në llogaritjet e peshës specifike që kjo vepër penale zë në grupin e ketyre krimeve nuk është e konsiderueshme diferenca).

Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike,

Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve;


Neni 298 Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufirit

Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga neni 114/b i Kodit Penal, Trafikimi i femrave:

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.4 për 100.000 banorë dhe në vitin 2008 është 0.63 për 100.000 banorë. Pra vihet re tendenca sado e lehtë në rritje të koeficientit të kriminalitetit.

Pesha specifike e kësaj vepre penale përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale është 3.2 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet si më poshtë:




Nga grafiku i mësipërm vihet re se në vitin 2005 ka një rënie të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 50 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka përsëri një rënie prej 46,2 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rënie prej 14,3 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 vihet re tendenca në rritje për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2007 prej 66,7 për qind.

Shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale paraqitet si vijon:

Prokuroria e krimeve të rënda ka rregjistruar gjithsej 10 procedime penale për nenin 114/b të Kodit Penal Trafikimi i Femrave që do të thotë 50 për qind e procedimeve të rregjistruar në shkallë republike. Rrethet Fier Korçë, Sarandë, Tiranë dhe Tropojë kanë rregjistruar nga një procedim penal për këtë vepër penale ose 5 për qind të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike për këtë vepër penale. Elbasani ka rregjistruar dy procedime penale ose 10 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale. Shkodra ka rregjistruar 6 procedime penale ose 15 për qind të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 114/b Trafikimi i femrave



Në lidhje me formën e këtij lloji kriminaliteti:

Theksojme se në Prokurorinë e Krimeve të Rënda janë regjistruar për paragrafin e dyte (organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave) të nenit 114/b Trafikimi i Femrave, tre procedime penale dhe për paragrafin e trete (bashkëpunimi, më shumë se një herë, apo shoqërimi me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarës...) është regjistruar vetëm një procedim penal.

Te dhena per te pandehurit Neni 114/b




Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 141/a Trafikimi i Mjeteve Motorike:

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 5.14 për 100.000 banorë dhe ne vitin 2008 është 8.96 per 100.000 banorë. Pra vihet re tendenca në rritje edhe tek koeficienti i kriminalitetit.

Pesha specifike e kësaj veprë penale përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale është 45 për qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet si më poshtë:



Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike



Ne vitin 2005, vihet re një rënie e procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale me 31.9 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 34.7 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rënie të lehtë prej 3 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme të procedimeve të rregjistruara në organin e prokurorisë prej 75, 3 për qind më shumë se në vitin 2007.


Krahasimi me vitin 2007

Kemi rritje me 75% të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale; rritje me 4% të procedimeve të dërguara për gjykim, rritje me 83% të numrit të të pandehurve të rregjistruar dhe ulje me 20% të numrit të të pandehurve të dërguar gjyqit. Ndërsa në vitin 2007 janë dërguar gjyqit 15% e procedimeve te rregjistruara në vitin 2008 janë dërguar 9% e tyre. Gjithashtu, në vitin 2007, 97% e të pandehurve i janë dërguar gjyqit dhe nga këta 71 % e tyre janë dënuar nga gjykata. Për vitin 2008, 53% e të pandehurve të rregjistruar i janë dërguar gjyqit dhe nga këta 57% e tyre janë dënuar nga gjykata (tregues jo i mirë për punën e organit të prokurorisë).




Për shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale, vëmë në dukje faktin se vetëm në rrethin e Matit për këtë veper penale nuk është rregjistruar asnjë procedim penal. Në Pukë është rregjistruar vetëm një procedim penal. Në Kavajë janë rregjistruar 2 procedime, në Tropojë 3, në Dibër, Lushnjë dhe Sarandë 4, në Kurbin 5, ne Elbasan dhe Korçë 6 procedime. Për rrethet të cilat kanë rregjistruar më shumë se 6 procedime penale për këtë vepër penale, shpërndarja gjeografike paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Vihet re se në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë rregjistruar 109 procedime që përbëjnë 38.4% të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale. E ndjekur nga Durresi me 10.2% të procedimeve, Fieri me 7,7%, Vlore 6,7 % dhe Shkodra me 6,7%.

Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike



Te dhena per te pandehurit Neni 141/a



Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve;


Tendeca për veprën penale të trafikimit të narkotikëve në 5 vite (2004-2008), procedime dhe të pandehur.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale, për 100.000 banorë ka qenë 1,4 në vitin 2007 dhe është bërë 2 në vitin 2008.

Pesha specifike e kësaj vepre penale përkundrejt totalit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale është 10.3 për qind.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet dinamika e këtij krimi në pesë vitet e fundit (2004-2008):

Neni 283/a Trafikimi i narkotikeve





për vitet 2004 dhe 2005 vihet re se jan rregjistruar i njëjti numër procedimesh penale për këtë vepër penale; në vitin 2006 vihet re një tendencë ulje me 16 .7 për qind e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin

2007 vihet re një rritje prej 25.7 për qind e procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme të procedimeve të rregjistruara për këtë veper penale, prej 47.7 për qind në krahasim me vitin 2007.

Përsa i takon procedimeve në vitin 2007 i janë dërguar gjyqit 64% e procedimeve të rregjistruara dhe në vitin 2008 i janë dërguar gjyqit 40 % e cështjeve të rregjistruara, pra vihet re një ulje e 24 % në vitin 2008 (tregues jo i mirë).


Në lidhje me të pandehurit, për këtë veper penale në vitin 2007, janë dënuar 89% e të pandehurve ndërsa në vitin 2008 janë dënuar 22% e të pandehurve, ndërkaq që 69% e të pandehurve të rregjistruar janë dërguar për gjykim (tregues jo i mirë për organin e prokurorisë).



Sa më sipër, e parë edhe në vite paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të kësaj veper penale. Ne grupin “te tjere” janë përfshirë rrethë të cilat kanë rregjistruar vetëm një procedim penal (Durrës, Korce, Mat dhe Sarandë). Vihet re se prokuroria e krimeve të rënda ka rregjistruar 48 procedime penale për këtë veper penale ose 71 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veper penale. Shkodra ka rregjistruar dy procedime penale për këtë veper penale ose 3 për qind të totalit. Gjirokastra dhe Pogradeci kanë rregjistruar nga tre procedime penale për këtë veper penale ose 4 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë veper penale. Në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë janë rregjistruar 8 procedime penale ose 12 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara.

Neni 283/a Trafikimi i Narkotikeve




Forma e kriminalitetit për këtë vepër penale:

Procedime të rregjistruara për paragrafin e dytë (bashkëpunimi ose më shumë se një herë) të nenit 283/a "Trafikimi i Narkotikëve" janë gjithësej 33. Theksojmë se, në vitin 2008, totali i procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale është 65 procedime. Pra, pesha specifike e procedimeve të rregjistruara bazuar në paragrafin e parë të nenit 283/a është 49.2 në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Ndërsa pesha specifike e procedimeve të rregjistruara bazuar në paragrafin e dytë të nenit 283/a është 50.8 në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale. Pra, ka një tendencë drejt veprave penale të parashikuara nga paragrafi i dytë i nenit 283/a, bashkëpunimi.

Te dhena per te pandehurit Neni 283/a



Neni 298 Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirit


Tendeca për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit në 5 vite (2004-2008), procedime dhe të pandehur.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë veprë penale, për 100.000 banorë ka qenë 6.6 në vitin 2007 dhe është bërë 6.97 në vitin 2008.

Pesha specifike e kësaj vepre penale përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale është 35 për qind.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008). Në vitin 2005 vihet re një rënie e regjistrimeve të procedimeve penale prej 9.4 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 vihet re një tendencë rritje me 25.4 për qind e procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 vihet re një rritje prej 31 për qind e procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale, prej 6.8 për qind në krahasim me vitin 2007.



Neni 298 Ndhimja per kalim te paligjshem te kufijve



Përsa i takon procedimeve në vitin 2007 i janë dërguar gjyqit 47% e procedimeve të rregjistruara dhe në vitin 2008 i janë dërguar gjyqit 51 % e çështjeve të rregjistruara, pra vihet re një ngritje prej 4 % në vitin 2008 (tregues pozitiv).


Në lidhje me të pandehurit, për këtë vepër penale në vitin 2007, janë dënuar 98% e të pandehurve ndërsa në vitin 2008 janë dënuar 90% e të pandehurve, ndërkaq që 83% e të pandehurve të rregjistruar janë dërguar për gjykim (tregues jo i mirë për organin e prokurorisë).

Sa më sipër, e parë edhe në vite paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Shpërndarja gjeografike

Vihet re se rrethet Lezhë, Mat, Pukë dhe Tropojë nuk kanë asnjë procedim të rregjistruar për këtë vepër penale. Dibra, Kruja dhe Kurbinë kanë vetëm 1 procedim penal ndërsa Shkodra ka dy procedime të tilla të rregjistruara. Për rrethet e tjera të cilat kanë rregjistruar më shumë se dy procedime, grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e tyre.



Në grupin “të tjerë” përfshihen rrethe të cilët kanë rregjistruar më pak se gjashtë procedime për këtë veprër penale.

Forma e kriminalitetit për këtë veprër penale:


Procedime të rregjistruara për paragrafin e tretë (bashkëpunimi ose më shumë se një herë) të nenit 298, “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve” janë gjithsej 36.

Theksojmë se, në vitin 2008, totali i procedimeve të rregjistruara për këtë veprër penale është 221 procedime. Pra, pesha specifike e procedimeve të rregjistruara bazuar në paragrafin e tretë të nenit 298 është 16.3 për qind në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për këtë veprër penale.

Nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike të procedimeve të rregjistruara për paragrafin e tretë të nenit 298 të Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve”, theksojmë se rrethet Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Kurbin dhe Lushnje kanë rregjistruar vetëm nga 1 procedim penal.

Durrës ka rregjistruar 5 procedime penale, Saranda dhe Vlora kanë rregjistruar 7 procedime penale dhe Korca 12 procedime penale (rrethe me pika kufitare).

Te dhena per te pandehurit Neni 298



TË PANDEHURIT

Të dhënat në lidhje me të pandehurit për veprat penale të trafikimit të paligjshëm gjatë vitit 2008, tregojnë se 429 persona janë marrë si të pandehur në total ose me rritje prej 15 për qind krahasuar me vitin 2007. Nga këto, 427 të pandehur për vitin 2008 janë meshkuj, ku 6 janë të mitur dhe 421 janë të rritur. Vetëm 2 femra janë marrë të pandehura për këto vepra penale ose 0,4 për qind e numrit total të të pandehurve. Në krahasim me vitin 2007, numri i të pandehurve të mitur është ulur me 33 për qind ndërsa i të pandehurve femra me 3.5 herë. Të dhënat gjithashtu tregojnë se 11 të pandehur janë me shtetësi të huaj për këto vepra penale.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, të dhënat për vitin 2008 tregojnë se 239 të pandehur ose 55.7 për qind e numrit total të të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 184 të pandehur ose 43 për qind janë me arsim të mesëm dhe vetëm 4 të pandehur ose 0.9 për qind janë me arsim të lartë. Në krahasim me vitin 2007, numri i të pandehurve me arsim deri 9-vjeçar është rritur me 21 për qind, i të pandehurve me arsim të mesëm me 10 për qind, ndërsa numri i të pandehurve me arsim të lartë është ulur me 2.5 herë.

VII. PËR VEPRAT PENALE PRODHIM TE NARKOTIKEVE, KULTIVIMIT DHE SHITJES SE TYRE

Gjatë vitit 2008 janë ndjekur penalisht 744 procedime dhe 473 persona janë marrë si të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 25 për qind të procedimeve të ndjekura dhe 14 për qind të numrit të personave të marrë si të pandehur. Është ngritur akuzë në gjykatë për 370 të pandehur dhe janë dënuar 232 të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me ulje prej 3.7 për qind të pandehurve ndaj të cilëve është ngritur akuzë në gjykatë dhe 22 për qind të dënuarve.

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar procedimet për këto vepra penale për vitet 2007-2008.

Kultivim, Prodhim,	2007	2008
--------------------	------	------

Narkotikeve	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhim & shitje	236	159	287	233	171	309	178	293	244	188
Neni 284 Kultivim	274	62	63	67	39	369	50	79	54	29
Neni 284/a Organizim & drejtim	0	1	0	2	0	1	0	1	0	0
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope	0	0	0	0	0	0	1	0	2	0
Neni 285 Mbajtja prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike	4	0	4	0	0	0	1	0	1	0
TOTALI	514	222	354	302	210	679	230	373	301	514

Procedimet penale të ndjekura sipas grupimit të këtyre veprave penale, janë si më poshtë: 369 procedime janë regjistruar për kultivimin e bimëve narkotike (neni 284) dhe 79 persona janë marrë si të pandehur. Është ngritur akuzë në gjykatë kundër 54 të pandehurve dhe janë dënuar 29. Krahasuar me vitin 2007 evidentohet një rritje prej 26 për qind të procedimeve të regjistruara, por me ulje prej 24 për qind të pandehurve dërguar për gjykim dhe 34 për qind të dënuarve për këtë vepër penale.

Për këtë grup veprash penale vihet re një rritje 32 e numrit të procedimeve të regjistruara pranë organit të prokurorisë. Rritje prej 4% në krahasim me vitin 2007. Duke ruajtur krahasimin me vitin 2007 theksojmë se vihet re një rritje prej 5% të numrit të pandehurve të rregjistruar dhe kemi pothuajse të njëjtin numer të pandehurve që janë dërguar gjyqit. Në krahasim me vitin 2007 kemi një rritje të numrit të pandehurve që janë dërguar gjyqit dhe që janë dënuar nga gjykata prej 3% (tregues pozitiv).

Vihet re se nga procedimet e regjistruara në vitin 2007, 43% e tyre janë dërguar gjyqit, ndërsa në vitin 2008 34% e procedimeve të regjistruara janë dërguar gjyqit (tregues jo i mire).

Për të pandehurit, theksojmë se në vitin 2007 kemi 85% e të pandehurve të rregjistruar janë cuar gjyqit dhe 70% e tyre janë dënuar nga gjykata. Ndërsa në vitin 2008, 81% e të pandehurve janë dërguar gjyqit dhe këta 72 % janë dënuar nga gjykata (tregues pozitiv).

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike është 16.3 për 100.000 banorë në vitin 2007 dhe 21.41 për vitin 2008. Pra vihet re tendeca në rritje e këtij koeficienti.

Pesha specifike e këtij grupi veprash penale në vitin 2007 përbënte 3% të të gjithë procedimeve të rregjistruara dhe në vitin 2008 kjo peshë specifike përbën 4% të numrit të përgjithshëm të procedimeve të rregjistruara.

TENDENCA


Vihet re për dy lloje veprash penale brenda këtij grupi. Veprat penale të parashikuara nga nenet 283 (prodhim dhe shitje narkotikesh) dhe neni 284 (Kultivimi i bimëve narkotike) kanë peshën specifike më të madhe në këtë grup veprash penale, përkatësisht 46% dhe 53% për vitin 2007 dhe 46% dhe 54% për vitin 2008.

Për veprën penale të parashikuar **nga neni 283 (Prodhim dhe Shitje Narkotikësh)**, vihet re një tendencë e lehtë në rritje të kësaj vepre penale kundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007, E shprehur në përqindje është përkatësisht 1,78% (2008) dhe 1.48% (2007).

Koeficienti i kriminaliteti për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 283 (prodhim dhe shitje narkotikësh) për vitin 2007 ishte 7.5 ndërsa për vitin 2008 është 9.75, pra koeficienti vjen në rritje.

Pesha specifike për këtë vepër penale përkundrejt totalit të procedimeve të grupit sipas tabelës së mësipërme në vitin 2007 ishte 45,9 për qind, ndërsa në vitin 2008 është 45.5 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sikurse duke edhe në grafikun e mësipërm, nga të dhenat statsikore, në vitin 2005 ka një rritje të procedime penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 8.2 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje të theksuar me 81.8 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 vihet re një ulje prej 18.3 për qind të procedimeve të rregjistruara përkundrejt vitit

2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 30.9 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2007.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e procedimeve të rregjistruara në rrethe të ndryshme të vendit për veprën penale të parashikuar nga neni 283 (Prodhim dhe Shitje Narkotikësh):



Sipas të dhënave statistikore, rezulton se rrethet Kavajë dhe Shkodër kanë rregjistruar 7 procedime penale ose 2 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara. Rrethet Berat dhe Sarandë kanë rregjistruar nga 9 procedime penale për këtë vepër penale ose 3 për qind të procedimeve të rregjistruara. Në prokurorinë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Gjirokastër janë rregjistruar 15 procedime penale ose 5 për qind e procedimeve. Në prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë janë rregjistruar 20 procedime ose 6 për qind e procedimeve; në Durrës 21 procedime ose 7 për qind e procedimeve të rregjistruara; në Fier janë rregjistruar 23 procedime penale për këtë vepër penale ose 7 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara; Në prokurorinë e rrethit Elbasan janë rregjistruar 25 procedime penale ose 8 për qind e totalit të procedimeve; në prokurorinë e rrethit gjyqësor Vlorë janë rregjistruar 29 procedime penale për këtë vepër penale ose 10 për qind e procedimeve; dhe në prokurorinë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë janë rregjistruar 124 procedime penale për këtë vepër penale ose 41 për qind e totalit të procedimeve.

Në nënndarjen “të tjerë” në grafikun e mësipërm janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar deri në pesë procedime për këtë vepër penale.

Forma e kriminalitetit për këtë vepër penale:


Procedime të rregjistruara për paragrafin e dytë (bashkëpunimi ose më shumë se një herë) të nenit 283, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" janë gjithsej 44.

Theksojmë se, në vitin 2008, totali i procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale është 309 procedime. Pra, pesha specifike e procedimeve të rregjistruara bazuar në paragrafin e dytë të nenit 283, është 14.24 për qind në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike të procedimeve të rregjistruara për paragrafin e dytë të nenit 283 të Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", theksojmë se rrethet Gjirokastrë, Kavajë, Pogradec, Sarandë dhe Tropojë, kanë rregjistruar vetëm nga 1 procedim penal.

Fieri ka rregjistruar 2 procedime penale, Korca ka rregjistruar 3 procedime penale; Durrësi ka rregjistruar 6 procedime penale, Vlora ka rregjistruar 7 procedime penale, Elbasani 9 dhe Tirana 12 procedime penale. Pra përqëndrimi më i madh është në rrethet Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Durrës.

Te dhena per te pandehurit Neni 283




Për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, "Kultivimi i Bimëve narkotike".

Koeficienti i kriminaliteti për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 284 (Kultivimi i bimëve narkotike) per vitin 2007 ishte 8.7 ndërsa për vitin 2008 është 11,6 pra edhe për këtë vepër penale koeficienti vjen në rritje.

Pesha specifike e kësaj vepre penale përkundrejt totalit të grupit në vitin 2007 ishte 53.3 për qind ndërsa në vitin 2008 pesha specifike është 54.34 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale.


Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 284 Kultivimi i Bimeve Narkotike



Në vitin 2005 ka një rritje të ndjeshme 3 herë më shumë, në lidhje me numrin e procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 ka një tendencë në ulje të procedimeve të rregjistruara prej 68.3 për qind në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2007 ka një rritje të ndjeshme prej 86.4 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2006. Në vitin 2008 ka një tendencë në rritje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, “Kultivimi i Bimëve narkotike”, prej 33.6 për qind në krahasim me vitin 2007.

Neni 284 Kultivimi i Bimeve Narkotike



Sipas të dhënave statistikore rezulton se në prokurorinë e rrethit Fier janë rregjistruar 9 procedime penale ose 2 për qind e procedimeve të rregjistruara; në prokurorinë e rrethit Gjirokastrë janë rregjistruar 63 procedime ose 17 për qind e procedimeve; në rrethin Korçë janë rregjistruar 6 procedime ose 2 për qind e procedimeve; në rrethin Krujë 11 procedime ose 3 për qind e procedimeve; në Sarandë janë rregjistruar 12 procedime penale ose 3 për qind e procedimeve; në Shkodër 159 procedime ose 43 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale; Vlora ka rregjistruar 6 procedime penale ose 24 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike dhe Tropoja ka rregjistruar 6 procedime ose 2 për qind të procedimeve. **Pra përqëndrimi më i madh është në rrethet Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë.**

Në grafikun e mësipërm, në nëndarjen “Të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar deri në pesë procedime penale për këtë vepër penale.


Forma e kriminalitetit për këtë vepër penale:

Procedime të rregjistruara për paragrafin e dytë (bashkëpunimi ose më shumë se një herë) të nenit 284, “Kultivimi i bimëve narkotike” janë gjithsej 3 procedime penale.

Theksojmë se, në vitin 2008, totali i procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale është 366 procedime. Pra, pesha specifike e procedimeve të rregjistruara bazuar në paragrafin e dytë të nenit 284, është 0.82 për qind në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike të procedimeve të rregjistruara për paragrafin e dytë të nenit 284 të Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”, theksojmë se rrethet Berat, Durrës dhe Vlorë kanë rregjistruar vetëm nga 1 procedim penal.

Te dhena per te pandehurit Neni 284



VIII. VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME SHFRYTËZIMIN DHE USHTRIMIN E PROSTITUCIONIT

27 procedime janë regjistruar për ushtrim prostitucioni, 33 persona janë marrë si të pandehur dhe 31 procedime janë dërguar për gjykim. 39 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar 49 (përfshirë dhe ata të mbartur në gjykim). Ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 49 procedime, 62 persona janë marrë si të pandehur dhe 43 procedime janë dërguar për gjykim. 54 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar 36, neni 113;

58 procedime janë regjistruar për shfrytëzim prostitucioni dhe shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese, 43 persona janë marrë si të pandehur dhe 31 procedime janë dërguar për gjykim. 39 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe 41 janë dënuar. Ndërsa për vitin 2007 janë regjistruar 64 procedime, 55 persona janë marrë si të pandehur dhe 33 procedime janë dërguar për gjykim. 44 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar 45, nenet 114 e 114/a;

Tabela paraqet sa më sipër:

Shfrytzimi Prostitucionit	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjyki m	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denuar
Neni 113 Prostitucioni	49	43	62	54	36	27	31	33	39	49
Neni 114 Shfrytezim prostitucioni	28	7	20	7	13	21	16	19	20	8
Neni 114/a Shfrytezim prostitucioni renduese	36	26	35	37	32	37	15	24	19	33
Neni 115 Mbajtja e lokaleve per prostitucion	4	3	7	3	3	1	1	1	1	2

TENDENCA

Neni 113 (Prostitucioni) dhe neni 115 (Mbajtja e lokaleve për prostitucion) është tendenca për këtë grup veprash penale.


Për veprën penale të prostitucionit, parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2007 ka qenë 1,5 ndërsa në vitin 2008 është 0,85.

Vepra penale e parashikuar nga neni 113 (Prostitucioni) ka një ulje prej 45% ne vitin 2008.

Pesha specifike e kësaj vepre penale përkunderjt totalit të procedimeve të rregjistruara në këtë grup veprash penale ishte 41.9 për qind në vitin 2007 dhe është 31.4 për qind në vitin 2008.

Vihet re se pesha specifike e këtij grupi veprash penale në raport me procedimet e rregjistruara për vitin 2007 ishte 0.73% ndërsa në vitin 2008 është 0.5%. Edhe ky është një tregues për tendencën në ulje të këtij kriminaliteti.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet ne grafikun e mëposhtëm:



Sipas grafikut të mësipërm, në vitin 2005 ka një rritje prej 27.3 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 ka një rritje prej 1.5 herë më shumë të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2007 ka përsëri një tendencë në rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 36.1 për qind në krahasim me vitin 2006. Në vitin 2008 ka një rënie prej 44.9 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale, Tirana ka rregjistruar 15 procedime penale ose 56 për qind të procedimeve penale në përgjithësi (zë pjesën më të madhe); Durrësi dhe Lushnja kanë rregjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 113 (Prostitucioni) të kodit Penal, ose 11 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale:



Në nëndarjen “Të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar vetëm nga një procedim penal për këtë vepër penale (Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Sarandë dhe Vlorë).

Për nenin 115 (Mbajtja e lokaleve për prostitucion).


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 0,12 ndërsa në vitin 2008 është 0.03, Pra tendenca është në ulje.

Për këtë vepër penale, të parashikuar nga neni 115 “Mbajtja e lokaleve për prostitucion”, ka një tendencë në ulje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në vitin 2008 përkundrejt vitit 2007 dhe ulja është 75%.

Pesha specifike e kësaj vepre penale përkundrejt totalit të grupit sipas tabelës në vitin 2007 ishte 3.42 për qind ndërsa në vitin 2008 është 1.12.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2005) paraqitet si më poshtë:

Neni 115 MBajtja e lokaleve per prostitucion



Sipas grafikut të mësipërm, në vitin 2005 ka një ulje prej 33.33 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 ka një rënie prej 50 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2007 ka një rritje të ndjeshme të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, tre herë më shumë në krahasim me vitin 2006. Në vitin 2008 ka një rënie prej 75 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale theksojmë se për vitin 2008 ka vetëm një procedim penal të rregjistruar në rrethin e Fierit.

IX. PËR VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT DHE QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË E KUNDRALIGJSHME TË PUNONJËSIT SHTETËROR OSE NË SHËRBIMIN PUBLIK,

gjatë vitit 2008 janë regjistruar 683 procedime penale dhe janë marrë të pandehur 295 persona ose me rritje prej 32 për qind të procedimeve të regjistruara dhe 20 për qind të numrit të personave të marrë si të pandehur për këto vepra penale, krahasuar me vitin 2007. Për këto vepra penale janë dërguar për gjykim 154 procedime penale me 300 të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me rritje 28 për qind të procedimeve dhe 40 për qind të pandehurve dërguar për gjykim dhe janë dënuar 155 të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 41 për qind të numrit të të dënuarve për këto vepra penale.

V.P. Korrupsion dhe te lidhura me detyren	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 164/a Korrupsion aktiv privat	1	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 164/b	1	0	0	0	0	2	2	6	6	1

Korrupsion pasiv privat										
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave me funksione publike	4	1	9	6	6	7	2	7	7	5
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionare te	2	3	3	6	4	5	5	4	11	5
Neni 248 Shperdorim detyre	311	82	129	125	53	474	102	186	184	81
Neni 70 KPU Shperdorim detyre	49	9	37	13	10	12	3	12	3	2
Neni 250 Veprime arbitrare	47	7	30	11	9	77	10	28	18	9
Neni 256 Shperdorim i kontributeve te dhena nga shteti	3	0	0	0	0	11	1	3	2	0
Neni 257 Perfitim i paligjshem	0	0	0	0	0	5	5	5	5	4
Neni 258 Shkelja e barazize ne tendera	11	0	1	10	0	23	6	15	30	19
Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike	34	9	25	10	9	59	16	26	31	28
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionareve te larte	1	0	1	0	0	2	0	0	1	1
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit	0	0	0	0	0	4	0	1	0	0
Neni 319/a Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 328 Dhenia e shperblimeve,	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Totali	467	111	236	181	91	683	154	295	300	155

1.1 Për vepra penale të korrupsionit janë regjistruar 81 procedime penale dhe janë marrë të pandehur 45 persona ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 47 për qind të procedimeve të regjistruara dhe 16 për qind të numrit të personave të marrë si të pandehur. Janë dërguar për gjykim 58 të pandehur dhe janë dënuar 40 ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 62 për qind të numrit të pandehurve dërguar për gjykim dhe 52.5 të dënuarve. **Sipas llojit të veprave**, procedimet penale të ndjekura janë si më poshtë:

- i) 1 procedim për korrupsion aktiv në sektorin privat, neni 164/a të K. Penal;
- ii) 2 procedime për korrupsion pasiv në sektorin privat, neni 164/b të K. Penal;
- iii) 7 procedime, për korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, neni 244 i K. Penal;
- iv) 5 procedime për korrupsion aktiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë, neni 245 i K. Penal;

- v) 59 procedime, për korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i K. Penal;
- vi) 2 procedime për korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë, neni 260 i K. Penal;
- vii) 5 procedime për korrupsion aktiv dhe pasiv të funksionarëve të drejtësisë, nenet 319 e 319/a.

1.2. Për vepra penale të shkeljes së barazisë në tendera, përfitim të paligjshëm, shkelje të kontributeve të dhëna nga shteti dhe dhënia e shpërblimeve janë ndjekur 39 procedime me 23 të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 56 për qind të procedimeve dhe 91 për qind të pandehurve për këto krime. Janë dërguar për gjykim 37 të pandehur dhe janë dënuar 23.

1.3. Për vepra penale të shpërdorimit të detyrës dhe veprime arbitrare janë ndjekur 563 procedime, me 226 të pandehur ose krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 28 për qind të procedimeve të ndjekura dhe 13 për qind të pandehurve. Janë dërguar për gjykim 205 të pandehur dhe janë dënuar 92 të pandehur ose me rritje prej 27 për qind të pandehurve dërguar për gjykim dhe 22 për qind të dënuarve krahasuar me vitin 2007.

Personat e proceduar penalisht për këto vepra përfaqësojnë: 153 nëpunës civil të Administratës Publike qendrore dhe vendore, të niveleve: funksionarë 13 persona, drejtues të lartë 18 persona, të mesëm 34 persona dhe të ulët 17 persona, dhe nëpunës të thjeshtë 71 persona.

Për këtë grup veprash penale, ka një rritje prej 46% të procedimeve të rregjistruara që shoqërohet me një rritje prej 39% të çështjeve të dërguara gjyqit dhe një rritje 25% të pandehurve të rregjistruar, rritje prej 66% të të pandehurve që i janë dërguar gjyqit dhe gjithashtu një rritje 70 % të të pandehurve që janë dënuar në krahasim me vitin 2007.

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale përkundrejt procedimeve të rregjistruara në total në vitin 2007 ishte 3% ndërsa në vitin 2008 është 4%.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2007 50% e të pandehurve që i janë dërguar gjyqit janë dënuar ndërsa në vitin 2008, janë dënuar 52% e tyre.

Kriminaliteti për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë për vitin 2007 ishte 14,7 ndërsa në vitin 2008 është 21.5, pra ka rritje të ketij fenomeni për vitin 2008.


Vihet re disa vepra penale kanë pesha specifike të konsiderueshme në këtë grup veprash penale.

Kështu, vepra penale e **Shpërdorimit të detyrës, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.**

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal "Shpërdorimi i detyrës" në vitin 2007 ishte 9.9, në vitin 2008 është 14.9


Pesha specifike e kësaj veprë penale në vitin 2007 ishte 66.6 për qind e totalit të grupit sipas tabelës së mësipërme dhe në vitin 2008 është 69.4.

Dinamika e kësaj veprë penale, në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet si më poshtë:



Në vitin 2005 vihet re një rritje prej 14.4 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 ka një rritje të ndjeshme prej 70 për qind të procedimeve të rregjistruara, në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2007 ka një rënie prej 11.6 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 52.4 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”.


Neni 248 Shperdorimi i detyres



Sipas të dhënave statistikore rezulton se rrethet:


Pukë ka rregjistruar 2 procedime penale; Tropojë 5 procedime penale; Dibër 6 procedime penale; Kavajë 9 procedime penale; Kukës dhe Lushnje 9 procedime penale; Mat 12 procedime penale; Gjirokastrë dhe Lezhë 13 procedime penale; Krujë 14 procedime penale; Berat dhe Kurbin 15 procedime penale; Sarandë 16 procedime penale; Fier 20 procedime penale; Korçë 23 procedime penale; Pogradec 26 procedime penale; Shkodër 34 procedime penale; Durrës 44 procedime penale; Vlorë 50 procedime penale; Elbasan 59 procedime penale dhe Tiranë 80 procedime penale.

Vlerat e procedimeve per Korrupsionin ne dy vite




Sic shihet edhe nga ky grafik, në këtë grup veprash penale, tendenca kryesore është e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i Detyrës”.

Neni 248 (Shperdorimi i Detyres)



Te dhena per te pandehurit Neni 248




Për veprën penale të parashikuar nga neni Neni 250 "Kryerja e Veprimeve arbitrare",

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë, në vitin 2007 ishte 1,5 ndërsa në vitin 2008 është 2.43 (është në rritje).

Pesha specifike që zë kjo veprë penale përkundrejt totalit të grupit sipas tabelës së mësipërme ishte 10 për qind në vitin 2007 dhe është bërë 11,3 për qind në vitin 2008.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 250 Kryerja e veprimeve arbitrare



në vitin 2005 vihet re një rënie prej 5.4 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 ka një rritje prej 5.7 për qind të procedimeve të rregjistruara, në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2007 ka një rritje prej 27 për qind të procedimeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 vihet re një rritje e ndjeshme prej 63.8 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga Kodi Penal, Neni 250 "Kryerja e Veprimeve arbitrare",


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, theksojmë se rrethi i Tiranës ka rregjistruar 17 procedime ose 23 për qind e totalit; Elbasani ka rregjistruar 8 procedime penale ose 11 për qind; Durrësi ka rregjistruar 7 procedime penale ose 9 për qind të totalit; rrethet Sarandë, Gjirokastër dhe Fier kanë rregjistruar nga 5 procedime penale ose nga 6 për qind secila; Shkodër, Korçë dhe Kavajë kanë rregjistruar 4 procedime penale ose nga 5 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Neni 250 Kryerja e veprimeve arbitrare



Në grafikun e mësipërm, në ndarjen “Të tjerë” janë përfshirë rrethet Berat, Tropojë, Kukës, Lushnjë, Mat, Vlorë, Krujë, Lezhë dhe Pukë të cilët kanë rregjistruar nga 1 deri në 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare”.

Te dhena per te pandehurit Neni 250




Neni 256 “Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti”:

Koeficienti i kriminalitetit për këtë veprë penale për 100.000 banorë, në vitin 2007 ishte 0.095 ndërsa në vitin 2008 koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 0.35 (vjen në rritje)


Pesha specifike e kësaj veprë penale në vitin 2007 ishte 0.64 ndërsa në vitin 2008 është 1.61, përkundrejt totalit të grupit sipas tabelës së mësipërme.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2005) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




në vitin 2005 ka një rritje 200 për qind të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 33.33 për qind të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri një ulje të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale prej 25 për qind dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme 266,7 për qind të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 256 i Kodit Penal “Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti”.

Te dhëna për të pandehurit Neni 256



Shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 256 Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti




Për veprën penale të parashikuar nga neni 256 i Kodit Penal “Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti”, në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë janë rregjistruar 6 procedime penale ose 55 për qind e totalit; në rrethet Berat, Shkodër, Kavajë, Pukë dhe Kukës është rregjistruar vetëm nga një procedim penal ose nga 9 për qind të totalit të procedimeve. Rrethet e tjerë të cilët nuk paraqiten në grafikun e mësipërm nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale.

Neni 257 “Përfitim i paligjshëm i interesave”


Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale për 100.000 banorë, në vitin 2008 është 0,16. Në vitin 2007 nuk ka patur të rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për grupimin e veprave penale sipas tabelës së mësipërme është 0.73.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Për veprën penale të parashikuar nga neni 257 i Kodit Penal “Përfitimi i paligjshëm i interesave” në vitet 2004, 2005 dhe 2007 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal. Në vitin 2006 janë rregjistruar 3 procedime penale dhe në vitin 2008 janë rregjistruar 5 procedime penale.



Në vitin 2008, është rregjistruar një procedim penal në Fier për këtë veprë penale dhe 4 procedime penale në prokurorinë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Kukës.


Në lidhje me nenin 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë veprë penale për 100.000 banorë, në vitin 2007 ishte 0,35 ndërsa në vitin 2008 është 0,72.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për grupimin e veprave penale sipas tabelës së mesipërme, në vitin 2007 ishte 2.35 për qind ndërsa në vitin 2008 është 3.37 për qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 258 Shkelja e barazise se pjesemarrësve ne tendera apo ankande publike



në vitin 2005 ka një rënie prej 44,44 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 60 për qind të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri një rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 37,5 për qind dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 109 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.

Shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 258 Shkelja e barazise se pjesemarrësve ne tendera apo ankande publike



në rrethin e Tiranës që mban edhe peshën specifike më të madhe të procedimeve penale, janë rregjistruar 5 procedime penale për këtë vepër penale ose 22 për qind e totalit në shkallë republike; në rrethin e Fierit janë rregjistruar 4 procedime penale për këtë vepër penale ose 17 për qind; në rrethin e Shkodrës janë rregjistruar 3 procedime penale ose 13

për qind dhe në rrethet Mat, Elbasan dhe Gjirokastrë janë rregjistruar nga 2 procedime penale për këtë vepër penale ose 9 për qind secili prej tyre. Në nënndarjen “Të tjerë”, në grafikun e mësipërm janë përfshirë rrethet të cilët kanë rregjistruar vetëm nga një procedim penal për këtë vepër penale (Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë dhe Sarandë).


Vepra penale e parashikuar nga neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”

Vihet re se vepra penale e parashikuar nga neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike ka pësuar një rritje prej 2% ne totalin e grupit.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale për 100.000 banorë, në vitin 2007 ishte 1,08 ndërsa ne vitin 2008 është 1,86.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për grupimin e veprave penale sipas tabelës së mësipërme, në vitin 2007 ishte 7.3 për qind ndërsa në vitin 2008 është 8.64 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




në vitin 2005 ka një rritje prej pothuajse 2.7 herë (275 për qind) të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 86.7 për qind të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri një rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 21,4 për qind dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 73.5 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” .

Te dhena per te pandehurit Neni 259



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale theksojmë se Tirana ka numrin më të madh të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale me 31 procedime ose 52 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara; Elbasani ka rregjistruar 7 procedime penale ose 12 për qind; Korca ka rregjistruar 5 procedime ose 8 për qind të totalit. Rrethet Shkodër dhe Vlorë kanë rregjistruar nga 4 procedime penale ose nga 7 për qind të totalit të procedimeve të rregjisruara për këtë vepër penale. Në nëndarjen “të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar nga 1 procedim penal (Berat, Kurbin, Pogradec, Pukë dhe Sarandë) dhe Kavaja ka rregjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”:

Koeficienti i kriminalitetit për këtë veprë penale për 100.000 banorë, në vitin 2008 është 1,13. Në vitin 2007 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me totalin e procedimeve të rregjistruara për grupimin e veprave penale sipas tabelës së mësipërme, në vitin 2008 është 0.59 për qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Sikurse shihet edhe nga grafiku në vitin 2004 është rregjistruar vetëm një procedim penal për këtë veprë penale. Në vitet 2005 e 2007 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale. Në vitin 2006 janë rregjistruar 3 procedime penale dhe në vitin 2008 janë rregjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”.

Nga pikëpamja e shpërndarjes gjeografike rezulton se rrethet Fier, Lezhë, Mat dhe Vlorë kanë rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale.

Per veprën penale të parashikuar nga neni Neni 328 “Dhenia e shpërblimeve dhe premtimeve”

Vihet re një ulje e procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale. Kështu, në vitin 2008 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale. Në vitin 2007 janë rregjistruar 3 të tilla.

Neni 328 Dhënia e shperblimeve dhe premtimeve




për veprën penale të parashikuar nga neni 328 “Dhënia e shperblimeve dhe premtimeve” rezulton se në vitet 2004, 2005 dhe 2008 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal. Ne vitin 2006 eshte rregjistruar 1 procedime penal per kete veper penale dhe në vitin 2007 janë rregjistruar 3 procedime penale për këtë vepër penale.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 70 i Kodit Penal Ushtarak “Shpërdorim detyre”

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 1.55 dhe në vitin 2008 është 0.38.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 70 Shperdorim detyre (KPU)



në vitin 2005 ka një rënie prej pothuajse 7.5 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 43.24 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një ulje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 7,5 për qind dhe në vitin 2008 ka një përsëri një rënie të ndjeshme prej 75.5 për qind të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 70 i Kodit Penal Ushtarak “Shpërdorim Detyre”.

Shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale paraqitet e tillë që në prokurorinë pranë gjykatës së rethit gjyqesor Vlorë janë regjistruar 11 procedime penale në vitin 2008 dhe vetëm një procedim penal në prokurorinë e Tiranës.

X. Për veprat penale që lidhen me pastrimin e parave

Gjatë vitit 2008 janë regjistruar 24 procedime penale dhe 16 persona janë marrë si të pandehur. Është ngritur akuzë në gjykatë kundër 14 të pandehurve dhe janë dënuar 4.

Krahasuar me vitin 2007, të dhënat evidentojnë një rritje prej 4,8 here me shume ne vitin 2008 të procedimeve të regjistruara, është rritur 3.2 herë numri i personave të marrë si të pandehur dhe 88% e tyre janë dërguar ne gjykate, nga të cilët vetëm 29% e tyre janë dënuar nga gjykata.

Pastrimi i Parave	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 287 Produktet e vepres penale	2	1	2	1	1	13	3	5	4	1
Neni 287/a Llogari anonime	0	0	1	1	0	1	1	1	2	0
Neni 287/b Pervetesimi i parave	3	1	2	2	3	10	4	100	8	3
Totali	5	2	5	4	4	24	8	16	14	4

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë ishte 0,16 në vitin 2007 dhe është bere 0,76 në vitin 2008.


TENDECA

Në këtë grup veprash penale tendenca vihet re në veprën penale të parashikuar nga **Neni 287 Pastrimi i Produkteve të Veprës Penale**.

Koeficienti i kriminalitetit për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal "Pastrimi i Produkteve të Veprës Penale" për 100.000 banorë ishte 0,41 në vitin 2007 dhe është bërë 0,06 në vitin 2008.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale përkundrejt totalit të grupit sipas tabelës së mësipërme është 54.2 për qind në vitin 2008, ndërsa në vitin 2007 ishte 40 për qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sikurse vihet re edhe në grafik, në vitin 2005 ka një rënie të ndjeshme të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale prej 66,67 për qind në krahasim me vitin 2004. Në vitin 2006 kemi një rritje prej 100 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005. Në vitin 2007 është rregjistruar i njëjti numër procedimesh penale sikurse në vitin 2006 (2 procedime penale) dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 84.6 për qind në krahasim me vitin 2007 .

Te dhena per te pandehurit Neni 287



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë penale theksojmë se është e pranishme në rrethet:

Tiranë, ka rregjistruar 8 procedime penale për këtë veprë penale ose 62 për qind të totalit të procedimeve; Vlora dhe Shkodra kanë rregjistruar nga 2 procedime penale ose 15 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale dhe Fieri ka rregjistruar vetëm 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga Neni 287 “Pastrimi i Produkteve të Veprës Penale”.

Për veprën penale të parshikuar nga neni 287/b i Kodit Penal “Përvetësimi i parave ose mallrave të vjedhura”:

Koeficienti i kriminalitetit për veprën penale të parashikuar nga neni 287/b i Kodit penal “Përvetësimi i parave ose mallrave të vjedhura” për 100.000 banore ishte 0,1 në vitin 2007 dhe është bërë 0,75 në vitin 2008.

Për këtë vepër penale në vitin 2007 janë rregjistruar 3 procedime penale dhe në vitin 2008 10 procedime penale, pra ka një rritje afërsisht 2,5 herë në vitin 2008 përkundrejt vitit 2007.

Procedimet janë rregjistruar përkatësisht:

Tiranë 5 procedime penale për këtë vepër penale; Durrës dhe Vlorë nga 2 procedime penale dhe në Kavajë 1 procedim penal.

PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIMIN E ORGANIZUAR

janë regjistruar 10 procedime penale për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal dhe 16 persona janë marrë si të pandehur. Është ngritur akuzë në gjykatë kundër 28 të pandehurve (duke përfshirë dhe të pandehurit të mbartur në hetim) dhe janë dënuar 9 të pandehur. Krahasur me vitin 2007 të dhënat e evidentojnë një ulje prej 20 për qind të procedimeve të regjistruara, mbi 2.4 herë të numrit të personave të marrë si të pandehur dhe mbi 2.3 herë të pandehurve të dënuar për këtë vepër penale.


Të dhënat tregojnë se puna e mirë e kryer nga prokuroria vitet e fundit kanë dhënë rezultate shumë të mira në luftën kundër krimit të organizuar, me ulje të ndjeshme të numrit të procedimeve dhe të pandehurve të regjistruar në krahasim me vitin 2007.

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar procedimet për këto vepra penale për vitet 2007-2008

Krimi i Organizuar	2007					2008				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 333 Organizatë kriminale	0	0	0	0	4	0	0	0	0	2
Neni 333/a Grup i strukturuar kriminal	12	5	39	28	21	10	5	16	28	9
Neni 334 Kryerja e veprave penale	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Totali	13	5	40	28	25	10	5	16	28	11


Dinamika në pesë vitet e fundit për procedimet penale të regjistruara në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal “Grupi i strukturuar kriminal”, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 333/a "Grupi i strukturuar kriminal"



Në vitin 2005 dhe 2006 janë rregjistruar numër i njëjte procedimesh penale për këtë veprë penale, 9 procedime penale. Në vitin 2007 vihet re një rritje e procedimeve të rregjistruara prej 33.3 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rënie të lehtë të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale prej 16.7 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 333/a



PËR VEPRAT PENALE NË FUSHËN EKONOMIKE

SEKSIONI "VJEDHJA E PASURISË"

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale që përfshihen në seksionin "VJEDHJA E PASURISË", në vitin 2007 ishte 140.36 ndërsa në vitin 2008 është 165.83 për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zënë ky grup veprash penale për vitin 2007 dhe për vitin 2008 janë përkatësisht 27.8 për qind në vitin 2007 dhe 30.3 për qind në vitin 2008.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale, fenomeni është tek vepra penale e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal "Vjedhja".

Koeficienti i kriminaliteti për këtë vepër penale për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 115.6 dhe në vitin 2008 është 137.5.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale përkundrejt totalit të seksionit ku ajo është strukturuar në Kodin Penal është 82.4 për qind në vitin 2007 dhe 82.9 për qind në vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



në vitin 2005 ka një rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 9.8 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie të lehtë prej 2.2 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 vihet re një tendencë në rritje prej 9 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 19.6 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.


Te dhena per te pandehurit Neni 134



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale, vihet re se është me shumë i pranishëm si fenomen në rrethin e Tiranës ku janë rregjistruar Tiranë 1518 procedime penale ose 35 për qind; Durrësi me 481 procedime penale ose 11 për qind, Korçë 287 procedime penale ose 7 për qind; Vlorë 346 procedime penale ose 8 për qind; Elbasan me 257 procedime penale ose 6 për qind; Shkodër me 207 procedime penale ose 5 per qind; Fier 154 ose 4 për qind, Berat me 136 procedime penale ose 3 për qind; Sarandë 157 procedime penale ose 4 për qind; Gjirokastër 125 procedime penale ose 3 për qind; Lezhë 108 procedime penale ose 2 për qind; Lushnje 102 procedime penale ose 2 për qind; Kavajë 95 procedime penale ose 2 për qind; rrethet, Dibër 79 procedime penale, Kukës 70 procedime penale dhe Kurbin 67 ose nga 2 për qind secili; rrethet, Pogradec 52 procedime penale, Krujë 46 procedime penale, Mat 33 procedime penale dhe Puke 22 procedime penale ose me nga 1 për qind dhe së fundi Tropoja ka rregjistruar 16 procedime penale.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 134 Vjedhja




Neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”


Koeficienti i kriminaliteti për këtë vepër penale për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 1.8 dhe në vitin 2008 është 2.5.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale përkundrejt totalit të seksionit ku ajo është strukturuar në Kodin Penal ishte 1.31 për qind në vitin 2007 dhe 1.5 për qind në vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




në vitin 2005 ka një rënie të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 69.2 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 1.5 herë në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 vihet re një tendencë në rritje prej 48.7 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 36.20 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.



Ne lidhje me shpërndarjen gjeografike të kesaj vepre penale theksojmë se në rrethin e Tiranës janë rregjistruar 23 procedime penale ose 29 për qind e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkalëe republike. Në rrethin e Fierit janë rregjistruar 12 procedime

penale ose 15 për qind; në rrethin e Elbasanit janë rregjistruar 10 procedime penale për këtë vepër penale ose 13 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale. Në rrethin e Korçës janë rregjistruar pesë procedime penale ose 6 për qind; në Shkodër dhe Lezhë janë rregjistruar nga katër procedime penale ose 5 për qind të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike. Në nëndarjen “të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilat kanë rregjistruar 1 deri në tre procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”.

Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën



Vepra penale e parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”,


Koeficienti i kriminaliteti për këtë vepër penale për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 1.8 dhe në vitin 2008 është 2.5.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale përkundrejt totalit të seksionit ku ajo është strukturuar në Kodin Penal ishte 1.31 për qind në vitin 2007 dhe 1.5 për qind në vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet e tillë: në vitin 2005 vihet re një rritje e numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në masën 8.5 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie të theksuar prej 52.5 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje të ndjeshme të rregjistrimit të procedimeve të kësaj vepre penale prej pothuajse 2,6 herë në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rënie prej 16.4 për qind të rregjistrimit të procedimeve penale për veprën penale të parashikuar

nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, në krahasim me vitin 2007.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



në lidhje me shpërndarjen gjeografike të rregjistrimit të procedimeve penale për veprën penale të parashikuar nga neni Neni 137 i Kodit Penal, “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, paraqitet e tillë që në rrethet:



Tiranë, janë rregjistruar 121 procedime penale ose e shprehur në përqindje, 35 për qind e totalit të procedimeve në shkallë vendi; Shkodër dhe Kukës kanë rregjistruar nga 58 procedime penale ose përkatësisht 16 për qind dhe 17 për qind të procedimeve në shkallë vendi; Kurbin ka rregjistruar 41 procedime penale, ose 12 për qind; Korca ka rregjistruar

21 procedime penale për këtë vepër penale ose 6 për qind të procedimeve të rregjistruara në total për këtë vepër penale; Mat ka rregjistruar 11 procedime penale ose 3 për qind të totalit; Elbasani ka rregjistruar 7 procedime penale ose 2 për qind të totalit të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në shkallë vendi; Durrësi dhe Kruja kanë rregjistruar nga 5 procedime penale ose 1 për qind të procedimeve të rregjistruar në shkallë vendi. Në nënndarjen të tjerë janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar nga 1 deri në katër procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.


Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”.

Koeficienti i kriminaliteti për këtë vepër penale për 100.000 banorë në vitin 2007 ishte 1.93 dhe në vitin 2008 është 3.3.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale përkundrejt totalit të seksionit ku ajo është strukturuar në Kodin Penal ishte 1.4 për qind në vitin 2007 dhe 2 për qind në vitin 2008.

Në lidhje me këtë vepër penale, vihet re se në vitin 2005 ka një rënie të lehtë të procedimeve të rregjistruara prej 5.5 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje të lehtë prej 4.7 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri një rënie të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 32,2 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të fortë të procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë” prej 70.5 për qind në krahasim me vitin 2007.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Te dhena per te pandehurit Neni 139




Shpërndarja gjeografike, për këtë vepër penale:

në rrethin e Tiranës, janë rregjistruar 27 procedime penale ose 26 për qind të procedime në total; në Durrës janë rregjistruar 20 procedime penale ose 19 për qind e totalit; në Vlorë janë rregjistruar 16 procedime penale ose 16 për qind; në rrethin e Korçës janë rregjistruar 10 procedime penale ose 10 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale; në Shkodër e Elbasan janë rregjistruar nga 6 procedime penale ose 6 për qind të procedimeve penale të rregjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 139 Vjedhja me dhune



SEKSIONI "MASHTRIMET" (Nenet 143- 149)

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale që pershihen në seksionin "MASHTRIMET", në vitin 2007 ishte 14.9 ndërsa në vitin 2008 është 15.9 për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zënë ky grup veprash penale për vitin 2007 dhe për vitin 2008 janë përkatësisht 27.8 për qind në vitin 2007 dhe 30.3 për qind në vitin 2008.

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale në vitin 2008 prej 23,8 për qind në krahasim me vitin 2007.

Shoqërohet me rritje edhe ngritja e akuzës në gjykate për këtë grup veprash penale. Keshtu rritja është 34,7 për qind më shumë se në vitin 2007.

Ka rritje të numrit të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2008 prej 47.8 për qind në krahasim me vitin 2007 dhe rritje të numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 39 për qind.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për:

Veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtrimi"

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 19.7 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 34.7 për qind më shumë.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 36 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 35,3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 12,1 dhe në vitin 2008 është 14.4.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 94.1 për qind dhe për vitin 2008 është 91 per qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 143 Mashtrimet




Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale prej 12,7 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje të lehtë prej 7.5 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje të theksuar të procedimeve penale për këtë veprë penale prej 66,4 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimet” prej 19.7 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 143



Shpërndarja gjeografike paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 143 "Mastrimet"




Sikurse vihet re dhe nga tabela e mësipërme kjo vepër penale është e pranishme në të gjithë territorin e vendit. Përqëndrimin më të madh të procedimeve të rregjistruara e ka rrethi i Tiranës me 40 për qind, rrethi i Elbasanit me 8 për qind të procedimeve të rregjistruara, Durrësi dhe Korca 7 për qind, Shkodër 6 për qind, Dibra 5 për qind Fier dhe Vlorë me nga 4 për qind dhe Kukësi me 3 për qind. Rrethet e tjera përbëjnë nga 2 dhe 1 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale.

Veprën penale të parashikuar nga neni 143/a i Kodit Penal “Skemat mashtruese dhe piramidale”

Ka një ulje të ndjeshme të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007, vetëm 1 procedim penal.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale ne vitin 2007 ishte 0.37 dhe në vitin 2008 është 0.031

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



1 procedim penal që është rregjistruar në vitin 2008 për veprën penale të parashikuar nga neni 143/a i Kodit Penal “Skemat mashtruese dhe piramidale” është rregjistruar në rrethin e Korcës.

Veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 385.7 për qind ose pothuajse 4 herë, në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007. Ka ulje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe ulja është 25 për qind.


Të pandehur të rregjistruar, rritje me pothuajse 4.5 herë në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007. Të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, ka rënie prej 12.5 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.22 dhe në vitin 2008 është 1.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 1.73 për qind dhe për vitin 2008 është 6.8 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 145 "Mashtrimi ne sigurime"



nga grafiku vihet se në vitin 2005 ka një rënie të ndjeshme prej 60 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale; në vitin 2006 ka një rritje 100 për qind të procedimeve të rregjistruara; edhe në vitin 2007 ka rritje prej 75 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të theksuar prej afërsisht 4 herë (ose 385.8 për qind) në krahasim me vitin 2007, të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”

Te dhena per te pandehurit Neni 145



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike theksojmë se në rrethin e Lezhës është rregjistruar numri më i madh i procedimeve penale për këtë vepër penale, 20 të tilla ose 59 për qind dhe në rrethin e Durrësit janë rregjistruar 11 procedime penale ose 32 për qind. Ne rrethet Tiranë, Gjirokastrë dhe Shkodër është rregjistruar nga një procedime penal për këtë vepër penale

SEKSIONI "SHKATËRRIMI I PRONËS" (nenet 150-161)

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale që përshihen ne seksionin "Shkatërrimi i pronës", në vitin 2007 ishte 29.21 ndërsa në vitin 2008 është 28 për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zënë ky grup veprash penale për vitin 2007 dhe për vitin 2008 janë përkatësisht 5.8 për qind në vitin 2007 dhe 5.2 për qind në vitin 2008.

Ka një rënie të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale në vitin 2008 prej 3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Shoqërohet me rritje të ngritjes së akuzës në gjykatë për këtë grup veprash penale. Keshtu rritja është 29 për qind më shumë se në vitin 2007.

Ka rritje të numrit të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2008 prej 16.5 për qind në krahasim me vitin 2007 dhe rritje të numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykate prej 15 për qind.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për:

Veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës"

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 24.2 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 26.5 për qind më shumë.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 46.7 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 37 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale ne vitin 2007 ishte 7,5 dhe në vitin 2008 është 9.2.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale per vitin 2007 ishte 25.6 për qind dhe për vitin 2008 është 32.8 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 150 "Shkatërrimi i pronës"



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale prej 12,12 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 35,8 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje të procedimeve penale për këtë veprë penale prej 17,4 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka përsëri rritje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës" prej 24,15 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 150




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë penale vihet re se:

rrethi i Tiranës ka numrin më të madh të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale 53 të tilla ose 18 për qind; Elbasani ka rregjistruar 39 procedime penale ose 13 për qind; Vlora ka rregjistruar 28 procedime penale ose 10 për qind; Durrësi ka rregjistruar 26 procedime penale ose 9 për qind; Fieri ka rregjistruar 23 procedime penale ose 8 për qind; Korca ka rregjistruar 20 procedime penale ose 7 për qind; Saranda ka rregjistruar 18 procedime penale ose 6 për qind; Gjirokastra ka rregjistruar 17 procedime penale ose 6

për qind dhe Shkodra ka rregjistruar 13 procedime penale ose 4 për qind. Rrethet Lushnje, Berat kanë nga 8 procedime penale ose 8 për qind; Lezhe dhe Krujë kanë rregjistruar nga 7 procedime penale; rrethet Pukë, Pogradec dhe Dibër kanë rregjistruar nga 5 procedime penale; Kavajë dhe Kurbin nga 4, Kukës 2 dhe Tropoja 1 procedim penal.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 150 "Shkaterrimi i prones"



Veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës me zjarr"

Ka një rënie të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 27 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 26.5 për qind më shumë.

Të pandehur të regjistruar, ulje me 21.4 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, ulje me 8.9 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 17,25 dhe në vitin 2008 është 12.5.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 59 për qind dhe për vitin 2008 është 44.4 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 21,4 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 6.3 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 115 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rënie të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës" prej 27 për qind në krahasim me vitin 2007.

Neni 151"Shkaterimi i prones me zjarr"



Sikurse shihet edhe nga grafiku, rrethet të cilat kanë numrin më të madh të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale janë: rrethi i Fierit ka 14 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale, Vlora Elbasani dhe Tirana kanë nga 9 për qind, Korca 8 për qind dhe Shkodra 6 për qind.

Veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal "Shkatërrimi i rrjetit elektrik"

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale prej 48.4 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rënie të procedimeve të derguara gjyqit për këtë veprë penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 60 për qind më shumë.

Të pandehur të regjistruar, ulje me 60 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, ulje me 60 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë veprë penale në vitin 2007 ishte 1 dhe në vitin 2008 është 1.5.


Pesha specifike që zë kjo veprë penale për vitin 2007 ishte 3.4 për qind dhe për vitin 2008 është 5.1 per qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale prej 8.7 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 52 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rënie të procedimeve penale për këtë veprë penale prej 18.4 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal "Shkatërrimi i rrjetit elektrik" prej 48.4 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 156



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale theksojmë se më shumë procedime penale janë rregjistruar në rrethin e Elbasanit gjithsej 9 procedime penale ose 20 për qind të totalit, Kurbini ka rregjistruar 8 procedime penale ose 17 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, Korca ka rregjistruar 5 procedime penale ose 11 për qind dhe Vlora 4 procedime penale ose 9 për qind. Rrethe të tjera kanë rregjistruar nga 1 deri në tre procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrejtit elektrik”. Berati, Dibër, Krujë, Lushnje Pogradec, Pukë dhe Sarandë nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale.

Veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit”

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 1.2 herë më shumë në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 53.9 për qind më shumë.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 100 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rritje me 53.8 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.7 dhe në vitin 2008 është 1.5.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 2.4 për qind dhe për vitin 2008 është 5.3 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 159 "Shkatërrimi i rrejtit të ujesjellesit"



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 125 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 11.11 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 120 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrejtit të ujësjellesit” prej 113.6 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 159



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale theksojmë se në rrethin e Elbasanit janë rregjistruar gjithsej 15 procedime penale ose 32 për qind dhe rrethi i Pogradecit ka rregjistruar 17 procedime penale ose 36 për qind. Rrethet Kavajë, Krujë, Lezhë, Lushnje, Shkodër dhe Vlorë nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale ndërsa rrethet e tjerë kanë rregjistruar nga një ose dy procedime penale.

Veprën penale të parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”.

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 100 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 100 për qind.

Të pandehur të regjistruar, rritje me 125 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykate, rritje me 80 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.7 dhe në vitin 2008 është 1.3.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 2.3 për qind dhe për vitin 2008 është 4.7 per qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 kë rënie të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 41 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 25 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 5 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia" prej 100 për qind në krahasim me vitin 2007.

SEKSIONI "KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE" (nenet 171-179/a)

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale që përfshihen në seksionin "Shkatërrimi i pronës", në vitin 2007 ishte 11 ndërsa në vitin 2008 është 7.6 për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zënë ky grup veprash penale për vitin 2007 dhe për vitin 2008 janë përkatësisht 2.2 për qind në vitin 2007 dhe 1.4 për qind në vitin 2008 (në raport me numrin total të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi).

Ka një rënie të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale në vitin 2008 prej 29.7 për qind në krahasim me vitin 2007

Shoqërohet me rënie të ngritjes së akuzës në gjykate për këtë grup veprash penale. Kështu rënia është 15.7 për qind më pak se në vitin 2007.

Ka rritje të numrit të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2008 prej 4.4 për qind në krahasim me vitin 2007 dhe rënie të numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 16.2 për qind.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për:

Veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”

Ka një rënie të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 59.5 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rënie të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 42.9 për qind më shumë.


Të pandehur të regjistruar, rënie me 38 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 31.3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 1,2 dhe në vitin 2008 është 0.5.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 10.8 për qind dhe për vitin 2008 është 6.2 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 172 "Kontrabanda me mallra qe paguhet akcize"



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 është regjistruar i njëjti numër procedimesh penale në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 162.5 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 kë rënie të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 12 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka përsëri një rënie të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal "Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë" prej 59.5 për qind në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale thekojmë se në rrethin Shkodër janë rregjistruar 5 procedime penale ose 33%, e totalit të grup veprave, në Durrës janë rregjistruar 3 procedime ose 20%; në Gjirokastrë janë rregjistruar 4 procedime penale ose 27%, Fier, Korçë dhe Tiranë kanë rregjistruar nga 1 procedim penale për këtë vepër penale ose nga 7% të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale (Krime në fushën e doganave).

Veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal "Kontrabanda me mallra të tjera"

Ka një rënie të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 57.2 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rënie të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 58 për qind më shumë.

Të pandehur të regjistruar, rënie me 42.2 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 54.1 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 7,3 dhe në vitin 2008 është 3.1

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 66.6 për qind dhe për vitin 2008 është 40.5 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të procedimeve penale prej 6.1 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 55.2 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 kë rënie të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 47.1 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka përsëri një rënie të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera” prej 57.2 për qind në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike kjo vepër penale vihet re më shumë në rrethet Tiranë dhe Kukës, rrethe të cilët kanë rregjistruar nga 16 procedime penale ose 16 për qind të totalit; Vlora dhe Korça kanë rregjistruar nga 10 procedime penale ose 10 për qind; Durrësi ka rregjistruar 13 procedime penale ose 13 për qind të totalit të procedimeve në shkallë vendi; Gjirokastra ka rregjistruar 8 procedime penale ose 8 për qind dhe Shkodra ka rregjistruar 5 procedime penale ose 5 për qind. Rrethet e tjerë kanë rregjistruar nga 1 deri në tre procedime penale për këtë vepër penale. Rrethet Berat, Kavajë, Krujë, Lushnje dhe Mat nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

Veprën penale të parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra me rregjim të ndërmjetëm”

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, 5 herë më shumë në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 100 për qind.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 2.3 herë më shumë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 1.3 herë më shumë në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0,06 dhe në vitin 2008 është 0.4

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 0.6 për qind dhe për vitin 2008 është 5 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 177 "Kontrabanda me mallra me rregjim te ndermjetem"



Në vitin 2005 ka rënie të procedimeve penale prej 77.8 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 50 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 100 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka përsëri një rritje të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal "Kontrabanda me mallra me rregjim të ndërmjetem" prej 5 herë më shumë në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 177



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale, theksojmë se është e pranishme më shumë në rrethin e Durrësit ku janë rregjistruar 11 procedime penale dhe në rrethin e Lezhës 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra me rregjim të ndërmjetëm”.

Veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, 98 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rritje të procedimeve të derguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 112.5 për qind.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 1.6 herë më shumë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 1.2 herë më shumë në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 1,6 dhe në vitin 2008 është 3.12

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 14.5 për qind dhe për vitin 2008 është 41 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 178 "Tregtimi dhe transportimi i mallrave qe jane kontrabande"



Në vitin 2005 ka rritje të procedimeve penale pre 51.5 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 4 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 4.2 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka përsëri një rritje të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal "Tregtimi dhe transportimi i mallrave qe janë kontrabandë" prej 98 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 178



Veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë"

Ka një rënie të ndjeshme të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, 64.3 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rënie të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 45.5 për qind.

Të pandehur të regjistruar, rënie me 82.4 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rënie prej 53.8 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.4 dhe në vitin 2008 është 0.16.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 4 për qind dhe për vitin 2008 është 2 për qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet ne grafikun e mëposhtëm:



Në vitin 2005 ka rënie të procedimeve penale prej 30 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 42.85 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 40 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rënie të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë" prej 64.3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale theksojmë se rrethet Kavajë, Korçë, Lushnje, Pogradec dhe Shkodër kanë rregjistruar vetëm nga 1 procedim penal për këtë vepër penale.

Veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë"

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, 100 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rritje të procedimeve të derguara gjyqit për këtë vepër penale ne vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 66.7 për qind.

Të pandehur të regjistruar, rënie me 100 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rënie prej 66.7 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.12 dhe në vitin 2008 është 0.25.


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 1.16 për qind dhe për vitin 2008 është 3.3 për qind.

Dinamika e kësaj veprë penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në vitin 2005 është rregjistruar vetëm një procedim penal në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 22 herë më shumë të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rënie të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 82.6 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë" prej 100 për qind në krahasim me vitin 2007.

Te dhena per te pandehurit Neni 179/a



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale theksojmë se në rrethin e Tiranës janë rregjistruar 5 procedime penale për këtë vepër penale dhe rrethet Elbasan, Gjirokastër dhe Vlorë kanë rregjistruar vetëm nga 1 procedim penal për këtë vepër penale.

Në seksionin “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet”, ka një tendencë që lidhet me nenin 181 të Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”

Veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”

Ka rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 15.2 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.


Ka rënie të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 57 për qind më shumë.

Të pandehur të regjistruar, rritje me 24.6 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 57.6 për qind në krahasim me vitin 2007.


Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 2.5 dhe në vitin 2008 është 2.9.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 78.2 për qind dhe për vitin 2008 është 78.4 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në vitin 2005 ka një rritje prej 1.6 herë më shumë në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 73 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 41.1 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, prej 15.2 për qind në krahasim me vitin 2007.



Në Tiranë janë rregjistruar 52 procedime penale për këtë vepër penale, në Vlorë 21 procedime penale dhe në Elbasan 7 procedime penale; Pogradeci ka rregjistruar 3 procedime penale, Berat, Durrës dhe Krujë kanë rregjistruar nga 2 procedime penale dhe Korçë e Sarandë nga një procedim penal.

SEKSIONI “FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE” (nenet 186-192/b)

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale që përfshihen në seksionin “Falsifikimi i dokumenteve”, në vitin 2007 ishte 44.8 ndërsa në vitin 2008 është 55 për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zënë ky grup veprash penale për vitin 2007 dhe për vitin 2008 janë përkatësisht 8.8 për qind në vitin 2007 dhe 10 për qind në vitin 2008 (në raport me numrin total të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi).

Ka një rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë grup veprash penale në vitin 2008 prej 23.4 për qind në krahasim me vitin 2007.

Shoqërohet me rënie të ngritjes së akuzës në gjykate për këtë grup veprash penale. Kështu rënia është 8.9 përqind më pak se në vitin 2007.

Ka rritje të numrit të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2008 prej 9.8 për qind në krahasim me vitin 2007 dhe rënie të numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 7.12 për qind.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për:

Veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”

Ka rritje të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 89.1 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 89.6 për qind më shumë.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 85.4 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 60.3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 16,9 dhe në vitin 2008 është 31.9.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 37.8 për qind dhe për vitin 2008 është 58 për qind.


Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve"



Sikurse shihet edhe nga grafiku, në vitin 2005 ka rritje të numrit të procedimeve penale të rregjistruara në krahasim me vitin 2004 prej 14.5 për qind; në vitin 2006 ka një rënie prej 10.5 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rënie të procedimeve penale për këtë vepër penale prej 13.2 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka rritje të ndjeshme të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve" prej 89.14 për qind në krahasim me vitin 2007.


Te dhena per te pandehurit Neni 186




Në lidhje me dënimin me burgim theksojmë se në pesë vitet e fundit përgjithësisht vihet re tendencë për kërtime të prokurorëve në rritje për këtë lloj dënimi. Kështu, në vitin 2005 ka rritje të kërtimeve për këtë lloj dënimi prej 8.1 në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje prej 8.9 për qind për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rënie prej 6.4 për qind për këtë lloj dënimi dhe në vitin 2008 ka rritje prej


7.1 për qind në krahasim me vitin 2007. Kërkesa e prokurorit me masë dënimi “burgim në minimum” zë 30.4 për qind të totalit të denimeve me burgim, si kërkime të prokurorit për vitin 2008. Në pesë vite, kërkimet e prokurorëve për këtë masë dënimi paraqitet në grafiku

n e
mëposh
tëm:




Në vitin 2005 vihet re një rritje prej 8.1 për qind për këtë masë dënimi nga prokurorët në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje prej 5 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rënie prej 13.5 për qind dhe në vitin 2008 ka përsëri një rritje të ndjeshme prej 31.8 për qind të masës së dënimit në minimum (kërkime të prokurorëve).

Kërkesa e prokurorit me masë dënimi “burgim mesatar” zë 42.9 për qind të totalit të denimeve me burgim, si kërkime të prokurorit për vitin 2008. Në pesë vite, kërkimet e prokurorëve për këtë masë dënimi paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji në pesë vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji



Ecuria në pese vitet fundit (2004-2008) paraqitet e tillë që: në vitin 2005 ka një rritje të ndjeshme prej 4 herë në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rënie të theksuar prej 71.4 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rënie prej 10 për qind për këtë kërkim nga ana e prokurorëve në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 vihet re përsëri një tendencë rënie për këtë kërkim nga ana e prokurorëve prej 33.3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim” si kërkime të prokurorit, në pesë vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Pezullimi i i ekzekutimit te vendimit me burgim



Nga të dhënat vihet re se në vitin 2005 ka rritje në kërkimet e prokurorëve për këtë parashikim ligjor prej 15.4 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje prej 14.4 për qind për këtë tregues në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rënie të

lehtë prej 1.3 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ky tregues vjen përsëri me një rritje fare të lehtë prej 0.65 për qind në krahasim me vitin 2007.

TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2008.


Aspekt shumë i rëndësishëm i punës së organit të prokurorisë është edhe zbatimi i parashikimeve ligjore të ligjit nr.8381, datë 21.4.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale “ (i ndryshuar).

Kështu, gjatë vitit 2008, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 6959 vendimeve penale të formës së prerë. Duke u krahasuar me vitin 2007 ka një rritje për këtë tregues prej 28.8 për qind.

Nga këto vendime janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 3294 vendime penale të formës së prerë ose duke u krahasuar me vitin 2007 ka një rritje prej 6.6 për qind të këtij treguesi.

Vendime të cilet kanë mbetur pa u ekzekutuar (ku përfshihen edhe vendimet e mbartura të paekzekutuara), gjatë vitit 2008 janë 4965, duke u krahasuar me vitin 2007, ka një rritje prej 42.6 për qind.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Gjatë vitit 2008 janë lëshuar gjithësej 5 urdhëra për ekzekutim vendimi me masën burgim i përjetshëm, nga këto janë ekzekutuar 4 prej tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 21 vendime penale të formës së prerë, përfshirë dhe të mbarturat. Për masën “Burgim” janë lëshuar 2643 vendimeper ekzekutim dhe janë ekzekutuar 1960 prej tyre, që do të thotë se 74 .2 për qind e këtyre vendimeve janë ekzekutuar. Mbeten të paekzekutuar 1454 vendime me këtë masë.

Për “gjobë” është urdhëruar ekzekutimi për 3519 vendime penale të formës së prerë, nga të cilat 970 janë ekzekutuar ose 27.6 për qind e tyre. Mbeten pa u ekzekutuar 3034 vendime penale të formës së prerë.

Për “dënime plotësuese” është urdhëruar ekzekutimi për 792 vendime penale dhe janë ekzekutuar 36 prej tyre ose 45.5 për qind. Mbeten ende vendime të paekzekutuara 456.

Sipas grup veprave penale:

“vepra penale kundër personit”, janë urdhëruar 1004 vendime penale për ekzekutim, janë ekzekutuar 593 ose 59 për qind e tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 850.

“vepra penale kundër pasurisë dhe ekonomisë”, janë urdhëruar 2689 vendime, janë ekzekutuar 1254 ose 46.6 për qind e tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 1863.

“vepra penale kundër mjedisit”, janë urdhëruar 122 vendime, janë ekzekutuar 31 ose 25.4 për qind e tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 106 vendime.

“krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”, janë urdhëruar 6 vendime, asnjë ekzekutuar dhe mbeten ende të paekzekutuara 14 vendime.

“Krime që çenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera”, është urdhëruar 1 vendim dhe mbeten ende i paekzekutuar 1 vendim.

“vepra penale kundër mjedisit”, janë urdhëruar 122 vendime, janë ekzekutuar 31 ose 25.4 për qind e tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 106 vendime.

“vepra penale kundër autoritetit të shtetit”, janë urdhëruar 2370 vendime, janë ekzekutuar 1123 ose 47.4 për qind e tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 1532 vendime.

“vepra penale kundër drejtësisë”, janë urdhëruar 244 vendime, janë ekzekutuar 159 ose 65.2 për qind e tyre dhe mbeten ende të paekzekutuara 115 vendime.

Pra peshën specifike më të madhe e zënë urdhërat për ekzekutim për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Veprat Penale	Urdhëra për ekzekutim	Vendime të Ekzekutuara	Vendime të Paekzekutuara
Kr.I Krime K/Njerezimit	0	0	0
Kr.II V.P K/Personit	1004	593	850
Kr.III V.P K/Pasurisë dhe Ekonomi	2689	1254	1863
Kr.IV V.P K/Mjedisit	122	31	106
Kr.V Krime K/Pavares. R/Kushtet.	6	0	14
Kr.VI Krime Cen/Marrdh.Shtete tjera	1	0	1
Kr.VII Akte Terroriste	0	0	1
Kr.VIII V.P K/Autorit.Shtetit	2370	1123	1532
Kr.IX V.P K/Drejtësisë	244	159	115
Kr.X V.P Prekin. Zgjedh. e Lira	9	15	43
Kr.XI V.P Kryera nga Band. Armat.	0	0	0
V.P sipas Kodit Penal Ushtarak	514	119	440

Rrethet në të cilët janë lëshuar më shumë urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale të formës së prerë janë:

Tiranë 1502 urdhëra për ekzekutim, 601 të ekzekutuara ose 40 për qind dhe 901 të paekzekutuara;

Durrës, 1141 urdhëra për ekzekutim, 433 të ekzekutuara ose 38 për qind dhe 1042 të paekzekutuara;

Shkodër, 601 urdhëra për ekzekutim, 214 të ekzekutuara ose 35.6 për qind dhe 488 të paekzekutuara;

Korcë, 428 urdhëra për ekzekutim, 147 të ekzekutuara ose 34.3 për qind dhe 365 të paekzekutuara;

Vlorë, 581 urdhëra për ekzekutim, 390 të ekzekutuara ose 55 për qind dhe 224 të paekzekutuara.

TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2008

Në lidhje me treguesit e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, gjatë vitit 2008, vihet re se nga prokurorët janë bërë gjithsej 15 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit, prej të cilave në katër raste është marrë vendim për ekstradim për jashtë shtetit dhe në një rast është marrë vendim kundër ekstradimit. Për ekstradim nga jashtë shtetit prokurorët kanë paraqitur katër kërkesa për të cilat nuk është disponuar me vendim.

Letërporosi nga jashtë, me kërkesë të prokurorit janë 172 të tilla prej të cilave në 56 raste është disponuar për pranim. Letërporosi për jashtë shtetit, ka 144 kërkesa të prokurorit prej të cilave 91 janë disponim për pranim dhe 2 për disponim për mospranim.

Njohja e vendimeve penale të huaja, kemi 123 kërkesa të prokurorit dhe janë 52 vendime për njohje e vendimit penal të huaj.

Vihet re se kërkesat e prokurorit për ekstradim për jashtë shtetit, janë bërë në rrethin e Vlores gjithsej 13 kërkesa dhe në rrethin e Durrësit 2 kërkesa.

Jane bërë 21 kërkesa nga prokuroria Berat për letërporosi nga jashtë; Durrës 12 të tilla; Fier 24, Kurbin dhe Krimet e Rënda 7, Lezhë 12, Shkodër 9, Tirana 56.

Letërporosi për jashtë, në Durrës janë rregjistruar 33 kërkesa, Prokuroria për Krime të Rënda 17, Berat 15, Lezha 13, Elbasani dhe Pogradeci 10.

Njohja e vendimeve penale të huaja, Berati kërkuar 7 të tillë, Durrësi 20, Fier 24, Elbasani 5, Kukës 32, Vlorë 29 dhe 2 Mat.

PRIORITETET E ORGANIT TË PROKURORISË GJATË VITIT 2008 DHE PRIORITETET PËR VITIN 2009

Dokumentet bazë nga të cilët burojnë edhe prioritetet e punës së organit të prokurorisë janë: 1- Marrëveshja e stabilizim asociimit; 2- Strategjia kombëtare për integrim dhe zhvillim 2007-2013; 3- progres raporti; 4- rekomandimet e Këshillit të Ministrave dhe vetë të dhënat e këtij raporti

Bashkëpunimi Ndërinstitucional, sidomos ai me Policinë Gjyqësore vlerësohet si shumë i rëndësishëm në efektivitetin e punës së organit të prokurorisë. Për këtë qëllim, Prokurori i Përgjithshëm ka nënshkruar një Urdhër të Përbashkët me Ministrin e Brendshëm, më datë 15.4.2008, për funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit. Urdhëri u hartua nga një grup i përbashkët i ngritur ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Brendshme. Urdhëri ka si qëllim:

- rritjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit në luftën kundër kriminalitetit.
- Të përcaktojë në mënyrë të qartë detyrimet dhe të drejtat e palëve respektive gjatë hetimeve paraprake;
- të parcaktojë funksionet në shërbimin e policisë gjyqësore që janë përgjegjës përpara prokurorit për përfundimin me sukses dhe në kohë të hetimeve;
- të formalizojë më mirë marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve dhe të evitojë ndonjë mbivendosje kompetencash që mund të kenë të dy institucionet;
- të rrisë efikasitetin e hetimeve paraprake duke i dhënë më shumë përparësi në hetimin dhe administrimin e çështjeve gjatë hetimeve paraprake shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit, në vend të seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive të rretheve gjyqësore;
- të rrisë shpejtësinë e hetimeve paraprake, meqënëse shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit kanë kapacitete njerëzore shumë më të mëdha se seksionet e prokurorisë;

Me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, në maj të vitit 2008 është ngritur një grup pune i përbërë nga 6 anëtarë, prokurorë dhe specialiste të fushës së TI. Grupi i punës ka si qëllim kryesor të vlerësoj programin ekzistues të menaxhimit të çështjeve penale "Dosja 2000", i cili nuk është funksional, dhe të bëjë rekomandimet përkatëse me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e tij me ndryshimet procedurale të ndodhura dhe programet e tjera të TI të përdorura nga policia e shtetit siç është programi TIMS.

Tashmë grupi i punës ka përfunduar vlerësimin e programit dhe ka bërë të gjitha rekomandimet përkatëse për përmirësimin dhe përshtatjen e tij me programe të tjera të përdorura nga autoritete të ndryshme të zbatimit të ligjit. Misioni OPDAT i SHBA në Shqipëri ka marrë përsipër të financojë azhurnimin e programit dhe instalimin e tij në të gjitha prokuroritë e vendit. Programi do të ndihmojë në rritjen e cilësisë të punës së

prokurorisë dhe bashkëpunimin polici-prokurori, si dhe do të ndihmojë prokurorët të kenë akses në baza të të ndryshme dhënash për nevoja të hetimit

Prokuroria do të rrisë kapacitetet e saj drejtuese dhe të menaxhimit strategjik, kapacitetet inspektuese dhe vlerësuese të prokurorëve nëpërmjet ndryshimeve ligjore të bëra në ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë si dhe nëpërmjet Projektit të Binjakëzimit me Spanjën dhe Italinë në bazë të Programit CARDS 2005. Projekti i Binjakëzimit me elementin bazë të tij rritjen e kapaciteteve të prokurorisë ka filluar në vjeshtë të 2008.

Mbrojtja e dëshmitarëve, personave të dëmtuar dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë është dhe do të mbetet në vëmendjen e prokurorisë. Edhe në këtë drejtim theksojmë se zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka qenë aktive në punën e bërë për përgatitjen e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9205, datë 15.03.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", me anë të përfaqësuesëve të organit të prokurorisë në grupin e punës për përgatitjen e këtij projektligji.

Lufta kundër korrupsionit ka qenë dhe do të jetë një ndër prioritetet e punës së prokurorisë.

Me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, me asistencën dhe mbështetjen e OPDAT-it, në datë 22 maj 2007, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit "Për krijimin e njësisë së përbashkët hetimore, për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit".

Në mbështetje të Kushtetutës dhe ligjit, si dhe në përmbushje të angazhimeve të këtij memorandumi, me urdhërin nr. 154, datë 6. 09. 2007, Prokurori i Përgjithshëm ka krijuar Njësinë e Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, si dhe Sektorin Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme. Në këto struktura, janë përzgjedhur dhe caktuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore më profesionistë dhe më me përvojë në këtë fushë, si dhe më me integritet profesional dhe moral.

Njësia e Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, si dhe Sektorin Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme është plotësuar me numrin e nevojshëm të stafit të kualifikuar. Gjithashtu, kjo njësi ka në përbërjen e saj shtatë ekipe me një ndarje të qartë funksionale midis gjashtë ekipeve hetuese dhe një ekipi verifikues, me ndarje dhe detyra të përcaktuara, si më poshtë:

- Gjashtë ekipe në përbërje të Njesisë së Përbashkët Hetimore do të ndjekin hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe do të ngrenë e përfaqësojnë akuzën në gjykatë për këto vepra penale, sipas natyrës së tyre dhe kompleksitetit të hetimeve.
- Ekipi i shtatë do të funksionojë si “Ekipi për Kërkimin dhe Vlerësimin e Informacionit për Regjistrimin e Procedimeve me Iniciativë”.
- Gjithashtu me financimin e Programit të Mijëvjeçarit (faza e dytë) do të ngrihen edhe funksionojnë pesë Njësi të Përbashkëta Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në rrethet kryesore të vendit, brenda vitit 2009, me të njëjtin status sikurse njësia e Tiranës. Këto struktura do të ngrihen në vazhdim të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Financave dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror. Synimi i këtij programi që është tashmë në fazën e zbatimit në bashkëpunim me OPDAT-in do të jetë ngritja e strukturave të reja dhe mbështetja e tyre me pajisje dhe trajnimin e stafit.
- Forcimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe llogjistike të Njesisë së Përbashkët Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë në fokus te prokurorisë gjatë vitit 2009;

Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

Faktorët që kanë ndikuar dhe po ndikojnë në rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar, janë:

- krijimi i seksionit të posaçëm, në Prokurorinë për Krime të Rënda për hetimin e pasurive të autorëve të krimit të organizuar në zbatim të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar;
- përmirësimet logjistike dhe i kapaciteteve për përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- përmirësimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit në planin rajonal dhe ndërkombëtarë; si dhe;
- bashkëpunimi i ngushtë me misionet ndërkombëtare që asistojnë policinë, prokurorinë dhe drejtësinë shqiptare.

Ka përfunduar dhe ka filluar funksionimi i një qendre të re për të realizuar përgjimet procedurale penale e vendosur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me synim për të veçuar pjesën e përgjimeve procedurale penale nga Qendra Kombëtare e Përgjimeve në SHISH, ku do të kryhen vetëm përgjimet parandaluese në zbatim të ligjit.

Përdorimi efektiv i mjeteve të veçanta të hetimit ka ndikuar në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë në ndjekjen penale për veprat penale që lidhen me krimin e organizuar, si dhe përdorimi i këtyre mjeteve është një nga faktorët kryesorë në rezultatet e arritura për

goditjen e krimit të organizuar. Është rritur në mënyrë të ndjeshme bashkëpunimi midis prokurorisë dhe shërbimeve inteligjente që merren me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Informacioni inteligjent i grumbulluar prej tyre ka shërbyer për orientimin më të mirë të hetimeve dhe ndërtimin e strategjive më të përshtatshme për goditjen e krimit të organizuar.

Efektiviteti dhe suksesi në përdorimin e mjeteve të veçanta të hetimit, evidenton disa raste të goditjes së veprimtarisë kriminale të organizuar, si: trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike; trafik të klandestinëve dhe falsifikimit të vizave e pasaportave, korrupsionit, identifikimin e vendndodhjes dhe arrestimin e disa drejtuesve të grupeve kriminale dhe autorëve të krimeve të rënda në kërkim, etj.

Prokuroria Shqiptare ka arritur progres të vazhdueshëm në bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe mbetet e angazhuar edhe për të ardhmen. Prokuroria Shqipëria në kuadrin e SEEPAG (South East European Prosecutor Advisory Group) Grupi Këshillimor i Prokurorëve të Evropës Juglindore, ka përmbushur të gjithë angazhimet e saj, duke marrë pjesë në aktivitete dhe takime rajonale, si dhe ka shkëmbyer informacione dhe ndihmë reciproke në fushën penale.

Bashkëpunimi në terren i Prokurorisë Shqiptare me homologët e vendeve të rajonit dhe më gjërë ka ardhur duke u përmirësuar. Në këtë vështrim mund të përmendim shkëmbim e letërporosive me interes të përbashkët me autoritetet e Drejtorisë Antimafia të Republikës Italiane, ai dhe me autoritetet gjyqësore Italo-Gjermane. Me autoritetet gjyqësore malazeze janë kryer hetime të përbashkëta për disa çështje. Me autoritetet gjyqësore maqedone është nxitur forcimi i bashkëpunimit rajonal ndërmjet prokurorive lokale dhe kufitare. Kemi shkëmbyer akte procedurale, me autoritetet gjyqësore kroate. Në bashkëpunim me autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar të Anglisë kemi disa procedime, si dhe janë kryer hetime të përbashkëta. Me autoritetet gjyqësore të SHBA-së kemi forcuar bashkëpunimin, duke kryer arrestime dhe ekstradime.

Lufta kundër trafiqeve të paligjshme

Me 3 prill 2008, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Shëndetësisë nënshkruan Udhëzimin e Përbashkët "Për trajtimin e bimeve narkotike apo psikotrope", me synim për të normuar procesin e sekuestrimit të lëndëve të dyshuara si narkotike, si dhe ruajtjen, magazinimin dhe analizat e tyre në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ky akt normativ i përbashkët i është dërguar prokurorëve të të gjithë niveleve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve në Policinë e Shtetit.

Lufta kundër pastrimit të parave

Në bashkëpunim dhe me asistencën e ngushtë të misionëve ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, Seksioni i Posaçëm në Prokurorinë për Krime të Rënda, po zbaton me efektivitet paketën ligjore që lidhet me sekuestrimin e aseteve të grupeve kriminale apo të dyshuarve që zhvillojnë aktivitet kriminal në fushat ku operon krimi i organizuar.

Përmirësimi i bashkëpunimit të Prokurorisë me (FIU) dhe Njësinë për Krimin Ekonomik mbetet një angazhim i rëndësishëm i Prokurorisë së Përgjithshme, me synim për të përmbushur detyrat funksionale në luftën e efektshme kundër pastrimit të parave. Është caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm pika e kontaktit – një prokuror i Drejtorisë Kundër Krimin të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme – për të bashkërenduar me strukturat e lartpërmendura. Në mbështetje të rregulloreve dhe udhëzime të hartuara në zbatim të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, bashkëpunimi midis FIU dhe Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë në fushën e pastrimit të parave, realizohet edhe nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve në lidhje me raste konkrete të transaksioneve të dyshimta.

Gjithashtu, brenda vitit 2009 do të ngrihet një rrjet informatik për përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, kryesisht Ministrinë e Brendshme dhe FIU –n;

Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr aktin normativ nr.1970/1, datë 19. 07. 2007 “Për zbatimin e dispozitës penale që parashikon ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të cilin ia ka dërguar prokurorëve të të gjithë niveleve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, bashkë me listën e subjekteve të licencuar nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor si “zyrë këmbimi”.

Rritja e kapaciteteve të prokurorisë, efektivitetit dhe efikasitetit të ndjekjes penale në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar

Në përmbushje të detyrimeve të saj, prokuroria ka marrë pjesë në mënyrë aktive në disa grupe punë për përmirësimin e legjislacionit, si më poshtë:

- Grupi i punës për hartimin e ndryshimeve ligjore në ligjin për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Ministrinë e Drejtësisë;
- Grupi i punës për përmirësimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë;
- Grupi i punës për hartimin e ligjit për Shërbimin Privat të Përmbartimit;
- Grupi i përbashkët i punës me Ministrinë e Brendshme për hartimin e urdhërit të përbashkët për funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit;
- Grupi i përbashkët i punës për hartimin e projektligjit “Për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar”, në Ministrinë e Drejtësisë;
- Grupi i punës për hartimin e ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Prokurori i Përgjithshëm ka miratur disa urdhëra gjatë vitit 2008 të cilët kanë si qëllim përmirësimin e punës në organin e prokurorisë, si më poshtë:

Urdhër nr. 148, datë 09.05.2008 “Për caktimin e shkallës së hierarkisë në Prokurori”. Urdhëri synon forcimin e kontrollit të brendshëm në prokurori duke standartizuar të drejtat dhe detyrimet që ka prokurori më i lartë për të ndihmuar, kontrolluar, udhëruar, udhëzuar, shfuqizuar ose ndryshuar aktet e prokurorit më të ulët.

Urdhër nr. 147, datë 09.05.2008 “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e shkallës së parë”. Urdhëri synon në standartizimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë si dhe rritjen e përgjegjësisë të prokurorëve.

Urdhër nr. 149, datë 09.05.2008 “Për përdorimin e modeleve të disa akteve kryesore procedurale penale”. Urdhëri synon përmirësimin dhe lehtësimin e punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe standartizimin e praktikës së hartimit të akteve procedurale në të gjithë vendin;

Urdhër nr. 171, datë 28.05.2008, “Për ekzekutimin e vendimeve penale dhe kontrollin e zbatimit të tyre” ku veç të tjerave normohet kontrolli i zbatimit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe prokurorëve u kërkohet të ndërhyjnë në institucionet përkatëse ose për të paraqitur kërkesë në gjykatë në rastet kur duhet të rivendoset ligji ose e drejta e shkelur duke kërkuar vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë disiplinore deri dhe në fillimin e procedimit penal ndaj tyre.

Prokuroria do të rrisë kapacitetet e saj drejtuese dhe të menaxhimit strategjik, kapacitetet inspektuese dhe vlerësuese të prokurorëve nëpërmjet ndryshimeve ligjore të bëra në ligjin për prokurorinë dhe me asistencën e ofruar nga Projekti i Binjakëzimit me Spanjën dhe Italinë në bazë të Programit CARDS 2005. Ky projekt binjakezimi ka si objektive kryesore të tij efikasitetin, transparencën dhe paanshmërinë e funksioneve të prokurorisë në vendin tonë; duke nxitur luftën kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe në mënyrë të vecantë pastrimin e parave dhe korrupsionin; eventualisht përshtetimin e afirmimit të plotë të vendit tonë në grupin e vendeve të shtetit të së drejtës (rule of law), progres dhe prosperitet social dhe ekonomik, nën një këndvështrim të perspektivës europiane. Fushat kryesore ku do të ndihmohet nëpërmjet këtij programi janë: inspektimet dhe vlerësimet e prokurorëve; marrëdhëniet me policinë gjyqësore; trajnimi i prokurorëve në përputhje me detyrat dhe funksionet që ata ushtrojnë.

Gjithashtu, me ndihmën e Projektit të Binjakëzimit, do të rritet kapaciteti i Drejtorisë së Inspektimit në mënyrë që ajo të kryejë inspektimet dhe vlerësimet e prokurorëve në të gjithë vendin, gjë që do të sjellë si rrjedhojë një prokurori më efikas dhe më transparent dhe si rrjedhim edhe uljen e korrupsionit brenda sistemit. Gjithashtu, projekti do të ndihmojë prokurorinë që ajo të ketë kapacitetin e duhur brenda ligjit, për t’u përballur efektivisht me shkelësit e tij. Hartimi i sistemit të vlerësimit të punës së prokurorëve, do të shërbejë gjithashtu dhe si kriter bazë për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve.

Ligji i ri për prokurorinë, i hartuar me pjesëmarrjen aktive të Prokurorisë së Përgjithshme në grupin e punës, parashikon kriteret të qarta dhe objektive për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve. Kandidatët duhet të konkurojnë ndërmjet tyre bazuar në përvojën e punës, meritën, aftësitë profesionale dhe vlerësimet e punës. Ndryshimet e propozuara, parashikojnë gjithashtu ngritjen e një sistemi që lejon shpërblimin me anë të promovimit dhe rritjes së pagës për vjetërsinë në punë me qëllim rritjen e kanaqësinë në punë.

Përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale, përbën një nga prioritetet e punës së organit të prokurorisë. Për këtë qëllim:

Në Mars të vitit 2006, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar një udhëzim të veçantë, nr. 228/1, datë 3.03.2006 "Mbi raportin e KE për parandalimin e torturës" dërguar gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Në udhëzim është normuar mënyra se si duhet të procedohet dhe të hetohen rastet e keqtrajtimit të personave që u është privuar liria.

Gjithashtu, në muajin Qershor 2005, Prokurori i Përgjithshëm, me një qarkore të posaçme, nr. 1760/1, datë 28.06.2005, dërguar prokurorëve të të gjitha niveleve, iu ka bërë të ditur Konkluzionet dhe Rekomandimet për Shqipërinë, të Komitetit Kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara, duke fokusuar në vëmendjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore se problemet e evidentuara si shqetësime dhe rekomandime në zbatim të konventës kundër torturës, duhet të jenë objekt i veprimtarisë së tyre.

Gjithashtu, në maj 2008, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar një urdhër të veçantë nr. 171, datë 28.05.2008, "Për ekzekutimin e vendimeve penale dhe kontrollin e zbatimit të tyre" ku veç të tjerave normohet kontrolli i zbatimit të ekzekutimit të vendimeve penale ku prokurorëve u kërkohet të ndërhyjnë në institucionet përkatëse ose për të paraqitur kërkesë në gjykatë në rastet kur duhet të rivendoset ligji ose e drejta e shkelur duke kërkuar vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë disiplinore deri dhe në fillimin e procedimit penal ndaj tyre.

PROGRES RAPORTI

Prioritet i punës së organit të prokurorisë do të jetë ajo ç'ka është evidentuar si problematike në të. Kështu, në punën e organit të prokurorisë ka qenë shumë i mirë bashkëpunimi me policinë dhe organet dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, bashkëpunim i cili do të synohet edhe në të ardhmen.

Në përgjithësi prokurorët kanë synuar të shqyrtojnë me hollësi ligjshmërinë e hetimeve të policisë, kur ata vendosin nëse një procedim do të fillojë ose do të vazhdojë. Në lidhje me këtë, prokurorët kanë monitoruar dhe do të monitorojnë respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e policisë.

Prokuroria e Përgjithshme, do të synojë të forcojë kapacitetet administrative të Njesisë së Posacme të Hetimit. Prokuroria e Përgjithshme, në zbatim edhe të rekomandimeve do të synojë:

Do të synojmë, standartizimin i raportimit të çështjeve do të përbëjë një progres kyç. Është evidentuar si e metë, mungesa e një manuali për prokurorët për dhënien e udhëzimeve për hetimet. Prokuroria e Përgjithshme edhe në këtë drejtim do të synojë përgatitjen e këtij manuali, me qëllim përmiresimin dhe unifikimin e praktikave hetimore në punën e organit të prokurorisë.

Orientime shumë të rëndësishme kemi patur në punën tonë edhe nga Rekomandimi 19(2000) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për prokurorinë.

Disa prej rekomandimeve të tij janë përfshirë dhe reflektuar edhe në punën e bërë nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme në përgatitjen e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë". Të tilla përmendim, parashikime të ligjit tashmë të miratuar në lidhje me garancinë për prokurorët në ushtrimin e funksioneve të tyre(kthimi në detyrë); Jemi përpjekur që në emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet dhe komandimet e bëra gjatë këtij viti në organin e prokurorisë, të bëhen pikërisht mbështetur mbi keto rekomandime, pra në përputhje me procedura të drejta dhe të paanshme që përfshijnë garancinë, kundër ndonjë përpjekje që favorizon interesat e grupeve të vecanta dhe duke përjashtuar diskriminimin për ndonjë shkak të tillë si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet politike ose bindje të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, pjesëmarrja në një minoritet kombëtar, statusi pasuror, lindja ose cdo status tjetër. Këto lëvizje janë bërë nga kriteret e njohura dhe objektive të tilla si profesionalizmi dhe eksperiencia, lëvizja e prokurorëve është bërë duke marrë në konsideratë nevojat e institucionit.

Në lidhje me procedimet te pokuroreve do të synojmë që ato të bëhen brenda parashikimeve e ligjore të garantojnë një vlerësim dhe një vendimmarrje objektive dhe të drejtë, duke ju nënshtruar një shqyrtimi të paanshëm dhe të pavarur.

Funksioni i prokurorit është një funksion publik shumë i rëndësishëm. Prokurorët së bashku me familjet e tyre duhet të jenë fizikisht të mbrojtur nga autoritetet kur siguria e tyre personale është vënë në rrezik si rezultat e kryerjes dhe ushtrimit të funksioneve te tyre.

Prokuroret, duhet të marrin pjesë në diskutimin publik të problemeve që lidhen me ligjin, administrimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Me qëllim që t'i pergjigjen më mirë formave të zhvilluara të kriminalitetit, në vecanti krimet të organizuar, specializimet e prokurorëve janë parë dhe do të shihen edhe në të ardhmen si prioritet. Mënyra e dytë e specializimit dhe që duhet t'i kushtohet rëndësi e

vecantë është krijimi i grupeve shumëdisiplinore të udhëhequr nga prokurorë të specializuar. Kjo do të thotë, që një grup që merret me krimin financiar, apo pastrimin e parave mund të përfshihen edhe ekspertë të fushave të ndryshme si llogaritarë, eksperte bankarë ose oficerë dogane të licensuar.

Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të prokurorisë, në vecanti caktimi dhe ricaktimi i çështjeve do të jetë prioritet për vitin 2009. Jemi të mendimit se ky proces duhet të bëhet mbi kritere paanësie dhe pavarësie me qëllim që të maksimizohet funksionimi i duhur i sistemit të drejtësisë penale, në vecanti niveli i kualifikimit të specializuar ligjor për çdo çështje.

Në vëmendjen tonë kanë qenë edhe ruajtja e marrëdhënieve ndërmjet prokurorisë dhe pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv.

Këto raporte duhet të jenë të tilla që prokurorët, në çdo rast, të jenë në gjendje që të ndjekin penalisht, pa patur pengesë, zyrtarët publikë për krimet e kryera nga ata, vecanërisht për korrupsionin, shpërdorimin e detyrës, dhunimin e rëndë të të drejtave të njeriut dhe krime të tjera të njohura nga e drejta ndërkombëtare.

Kujdes kemi bërë dhe do të bëjmë edhe në të ardhmen në marrëdhëniet e prokurorëve me trupën e gjyqtarëve. Në këtë drejtim, në punën tonë kemi synuar të respektojmë me rigorozitet pavaresinë dhe paanësinë e gjyqtarëve, në vecanti duke mos hedhur dyshime mbi vendimet gjyqësore dhe as të vonojnë ekzekutimin e tyre, përvec rastit kur ushtrohet e drejta e apelit ose kur kërkohen shpjegime të tjera procedurale. Kemi synuar që prokurorët të jenë të ndershëm dhe objektivë gjatë procedurave gjyqësore, vecanërisht duke siguruar që gjykatës t'i jenë paraqitur të gjitha faktet që kanë lidhje me ngjarjen dhe argumentat ligjore të nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.

Kemi vlerësuar dhe do të vlerësojmë edhe përgjegjësitë e prokurorit në drejtim të individit, parë si një aspekt shume i rëndësishëm i administrimit të drejtësisë penale. Synojmë në punën tonë që prokurorët të mos fillojnë ose vazhdojnë ndjekjen penale kur rezulton që akuza është e pabazuar. Kemi synuar në punën tonë respektimin e parimit të "barazisë së armëve" dhe në mënyrë të vecantë të nxjerrim për palët e tjera çdo informacion që ata kanë, i cili mund të ndikojë në një proces të drejtë penal, përvec rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Kemi synuar ruajtjen e sekretit për informacionin e përfituar nga palët e treta, në vecanti aty ku prezumimi i pafajësisë është në rrezik, me përjashtim të rastit kur zbulimi i informacionit kërkohet në interes të ligjit, detyrim i cili buron edhe nga Kodi i Etikes i Prokurorëve.

E drejta për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatës lidhet ngushtë me funksionin e prokurorit, pasi kjo e drejtë është një nga mjetet për të siguruar zbatimin e ligjit dhe për të garantuar efektivitetin e sistemit të së drejtës penale, vecanërisht për sa i takon ligjshmërisë së vendimeve të gjykatës dhe respektimit të afateve në zbatimin e ligjit. Domethënë, kemi kërkuar që prokurorët të ankimojnë vendimet duke patur arsye

thelbësore, për të cilën nga aktorët ndërkombëtarë që na monitorojnë është vlerësuar si shumë e rëndësishme. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe Urdhëzimi nr.1, datë 14.11.2008 i Prokurorit të Përgjithshëm "Për ushtrimin me eficensë të së drejtës së ankimit".

Konsultimi me përfaqësuesit e prokurorisë rreth këtyre nevojave në përgatitjen e buxhetit është një mënyrë e mirë për të përcaktuar se cilat janë nevojat e vërteta. Organi i prokurorisë për vitin 2008 ka patur shpenzime të krijuara gjatë periudhës raportuese progresive prej 5755845 për perkthyes, 8603304 për avokat dhe 12285011 për ekspertë të ndryshëm, fatura të cilat në krahasim me vitin 2007 vijnë në rritje.

Prokurori i Përgjithshëm është anëtar i Komitetit Këshillues për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

Në raportin e vitit të kaluar kemi kërkuar disa masa ligjore dhe administrative:

- 1) ndryshime ligjore që të zgjerojnë autonominë investigative të policisë dhe zgjerimin e pushtetit të saj hetimor, me qëllim për t'i hapur rrugë nismës së policisë në drjetim të zgjerimit të hetimeve, pa qenë nevoja për të pritur domosdoshmërisht udhëzime nga prokurori;
- 2) oficerët e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit në seksionet e prokurorive kanë shkeputur lidhjet me armën e origjinës. Duhet të bëhen saktësime në ligjin nr. 8677, datë 2.11. 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore" duke vendosur detyrime për kontakte të vazhdueshme për bashkërendimin e punës me kolegët e tyre në komisariate dhe për ndjekjen e hetimeve në vijimësi.
- 3) Duhet të normohet detyrueshmëria e drejtuesve të policisë për të lënë në dispozicion të vartësve të tyre edhe një kohë të domosdoshme për të ndjekur hetimet e procedimeve të filluara me vendngjarje ose pas referimit të bërë prej tyre. Një zyrë e posacme për të ndjekur problemet që lidhen me zbatimin e detyrave të policisë gjyqësore për të kryer hetime, duhet të krijohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Ende nuk janë përmbushur nga pikëpamja legislative dhe i konsiderojmë si të domosdoshme.

Të nderuar deputetë!

Ky raport jep sinjale pozitive dhe kurajoje për vendin tonë që është drejt rrugës së garantimit të sigurisë, prosperitetit dhe stabilitetit. Bazuar ne atë që ne njohim për kushtet shoqërore të cilat mbështesin dhe nxisin krimin e organizuar ndërkombëtarisht, gjëndjen ekonomike dhe shoqërore të vendit tonë, jemi të mendimit se vendi ynë nuk është në kushtet që do të ketë mbështetje të posacme për të në të ardhmen, duke marrë në konsideratë edhe indikatorët e përmendur në këtë raport. Fakti që disa prej treguesve dhe koeficientëve për vepra penale të ndryshme janë në rënie është një mbështetje akoma më e fortë dhe reale për këtë.

Sfida të mëdha kemi ende përpara, përderisa reforma në drejtësi është ende në qendër të vëmendjes. Bazuar në tendencat e vëna në dukje në këtë raport, është e qartë se

punë mjaft e mirë është bërë deri tani, por probleme ende ka dhe do të jenë në fokusin e punës tonë.

Ju siguroj se Prokuroria në të gjitha hallkat e saj do të realizojë prioritetet në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimit të organizuar, korrupsionit në vecanti duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ju faleminderit !

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA

